



**Republika e Kosovës**  
**Republic of Kosovo - Republika Kosova**  
**Qeveria- Government -Vlada**

---

**PROJEKTLIGJI PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON HIGHER EDUCATION IN THE REPUBLIC OF KOSOVA<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O VISOKOM OBRAZOVANJU U REPUBLICI KOSOVO<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 116-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendim Nr.02/116 të datës 28.12.2022.

<sup>2</sup> Draft Law on Higher Education in the Republic of Kosova, was approved on the 116nd meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 02/116, dated 28.12.2022.

<sup>3</sup> Nacrt Zakona o Visokom Obrazovanju u Republici Kosovo, u usvojen je na 116 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br. 02/116, datum 28.12.2022.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i këtij Ligji është përcaktimi i parimeve dhe krijimi i bazës ligjore për kushtet dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë arsimore, kërkimore-shkencore e artistike, rregullimin, funksionimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës në përputhje me standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi i Ligjit</b></p> <p>Fushëveprimi i këtij Ligji shtrihet në të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe autoritetet përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosova, Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosova,</p> <p>Approves:</p> <p><b>LAW ON HIGHER EDUCATION IN THE REPUBLIC OF KOSOVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>The purpose of this Law is the determination of principles and creation of legal basis for the conditions and exercises of the activity of education, scientific-research and artistic activity, regulation, functioning, and quality assurance in higher education in the Republic of Kosova in accordance with the standards of the European Higher Education Area.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope of Law</b></p> <p>The scope of this law extends to all institutions of higher education and the authorities responsible for higher education in the Republic of Kosova.</p>	<p>Skupština Republike Kosova, Na osnovu član 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O VISOKOM OBRAZOVANJU U REPUBLICI KOSOVO</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Cilj</b></p> <p>Cilj ovog Zakona je određivanje principa i stvaranje pravne osnove za uslove i način primenjivanja obrazovne, naučno-istraživačke i umetničke delatnosti, regulisanje, funkcionisanje, i obezbeđivanje kvaliteta u visokom obrazovanju u Republici Kosovo u skladu sa standardima Evropskog prostora visokog obrazovanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Oblast delovanja zakona</b></p> <p>Oblast delovanja ovog zakona se proteže na sve institucije visokog obrazovanja i organe odgovorne za visoko obrazovanje u Republici Kosovo.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë kuptimin si vijon:</p> <p>1.1. <b>Ministria</b> – Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. <b>Ministri</b> – Ministri përgjegjës për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.3. <b>Arsimi i lartë në tekstin e mëtejme AL</b> – arsimimi që ofrohet pas arsimit të mesëm nga institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore;</p> <p>1.4. <b>Akreditim</b> - proces formal i vlerësimit të cilësisë së një institucioni të arsimit të lartë dhe i programeve të tij të studimit, përmes të cilit Agjencia e Kosovës për Akreditim në tekstin e mëtejme AKA, përcakton se janë plotësuar standardet dhe kriteret e kërkuara të cilësisë;</p>	<p>1. Terms used in this Law have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Ministry</b> - The Ministry responsible for higher education in the Republic of Kosova;</p> <p>1.2. <b>Minister</b> - The Minister responsible for higher education in the Republic of Kosova;</p> <p>1.3. <b>Higher education</b> in further text HE - education provided after secondary education from higher education institutions, according to the provisions of this law and other sub-legal acts;</p> <p>1.4. <b>Accreditation</b> - a formal process of quality assessment of a higher education institution and of its study programs through which the Kosova Accreditation Agency in further text KAA determines that the required quality standards and criteria have been met.</p>	<p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeći značaj:</p> <p>1.1. <b>Ministarstvo</b> - Ministarstvo nadležno za visoko obrazovanje u Republici Kosovo.</p> <p>1.2. <b>Ministar</b> - Ministar odgovoran za visoko obrazovanje u Republici Kosovo;</p> <p>1.3. <b>Visoko obrazovanje u daljem tekstu VO</b> - obrazovanje koje nakon srednjeg obrazovanja nude institucije visokog obrazovanja, u skladu sa ovim zakonom i drugim podzakonskim aktima.</p> <p>1.4. <b>"Akreditacija"</b> - formalni proces procene kvaliteta određene institucije visokog obrazovanja i njenih programa njihovih studijskih programa pomoću koje Kosovska agencija za akreditaciju u daljem tekstu KAA određuje da su ispunjeni potrebni standardi i kriterijumi kvaliteta;</p>

<p>1.5. <b>Mbrojtja e të dhënave</b> dhe emërtimet në lidhje me to kanë kuptimin e bashkëngjitur atyre në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;</p> <p>1.6. <b>Rrjeti Evropian i Qendrave për Informim</b> - rrjeti evropian i qendrave për informim akademik, të cilat ofrojnë informacione për njohjen e diplomave, titujve dhe kualifikimeve të tjera ndërkombëtare për sistemin arsimor, si për vendet e huaja, ashtu edhe për vetë vendin anëtar të këtij rrjeti si dhe për mundësitë e studimit jashtë vendit, duke përfshirë edhe pagesat, bursat dhe këshilla për çështje praktike në lidhje me mobilitetin dhe barasvlerën;</p> <p>1.7. <b>Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive- ECTS</b> - Sistemi Evropian i Transferit dhe Akumulimit të Kredive, i cili cakton kreditë për komponentët e kursit, të bazuara në ngarkesën e punës së studentëve për të arritur rezultatet e të nxënit e një drejtimi të veçantë të studimit;</p> <p>1.8. <b>Zonë Evropiane e Arsimit të Lartë</b> - ka kuptimin e përcaktuar në Deklaratën e Bolonjës të vitit 1999;</p>	<p>1.5. <b>Data protection</b> and designations related to them have the meaning attached to them in personal data protection legislation.</p> <p>1.6. <b>European Network of Information Centers</b> - the European network of academic information centers, which provide information on the recognition of diplomas, titles and other international qualifications, for the education system, both for foreign countries and for the member country of this network as well as study abroad opportunities, including tuition and scholarships, and advice on practical issues related to mobility and equity.</p> <p>1.7. <b>European Credit Transfer System -ECTS</b> - The European Credit Transfer and Accumulation System, which assigns credits to course components, based on student workload to achieve the learning outcomes of a particular field of study.</p> <p>1.8. <b>European Higher Education Area</b> - has meaning set out in the Bologna Declaration of 1999.</p>	<p>1.5. <b>Zaštita podataka</b> i nazivi u vezi njih imaju priložene u zakonodavstvu o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>1.6. <b>Evropska mreža centara za informisanje</b> - Evropska mreža centara za akademsko informisanje, koji pružaju informacije o priznavanju diploma, zvanja i drugih međunarodnih kvalifikacija, za obrazovni sistem, kako za strane zemlje, tako i za zemlju članicu ove mreže, kao i mogućnost studiranja u inostranstvu, uključujući uplate i stipendije, i praktične savete o mobilnosti i ekvivalenciji.</p> <p>1.7. <b>Evropski sistem prenosa kredita koji -ECTS</b> - Evropski sistem prenosa i akumulacije kredita koji određuje kredite za komponente kursa, zasnovanim na poteškoće rada studenata da postignu rezultate učenja određenog smera studije.</p> <p>1.8. <b>Evropski prostor visokog obrazovanja</b> - ima značenje određeno u Bolonjskoj deklaraciji iz godine 1999.</p>
---	--	---

<p>1.9. <b>Sigurim i cilësisë</b> - nënkupton tërësinë e politikave, proceseve dhe aktiviteteve në nivel shtetëror dhe institucional për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në arsimin e lartë. Sigurimi i cilësisë, po ashtu ka të bëjë me mësimdhënien dhe të nxënit në arsimin e lartë, përfshirë edhe mjedisin e të nxënit dhe ndërlidhjet me kërkimin shkencor dhe inovacionin;</p> <p>1.10. <b>Rezultatet e të nxënit</b> - arritjet në nxënie që shprehen në terma të asaj se çka pritet që studenti të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të shkallës së studimeve apo të modulit. Aty mund të përfshihen edhe qëndrimet, sjelljet, vlerat dhe etika;</p> <p>1.11. <b>Të mësuarit gjatë gjithë jetës</b>- arsimimi i përgjithshëm, arsimimi dhe aftësimi profesional, arsimimi joformal dhe nxënia informale, të fituara gjatë gjithë jetës, duke rezultuar në ngritjen e njohurive, shkathësive dhe të kompetencave brenda perspektivës personale, shoqërore, qytetare apo asaj të punësimit;</p> <p>1.12. <b>ENIC/NARIC Kosova</b> - Qendra shtetërore për njohje dhe informim akademik. ENIC/NARIC Kosova, ndihmon në promovimin e lëvizshmërisë</p>	<p>1.9. <b>Quality Assurance</b> - means the set of policies, processes and activities at the state and institutional level for quality assurance and advancement in higher education. Quality assurance also relates to teaching and learning in higher education, including the learning environment and links with research and innovation;</p> <p>1.10. <b>Learning Outcomes</b> - Learning Outcomes expressed in terms of what a student is expected to know, understand and be able to do after completing study degree or module. There may be also included attitudes, behaviors, values, and ethics.</p> <p>1.11. <b>Lifelong learning</b> - general education, vocational education and training, non-formal education and informal learning, acquired throughout life, resulting in the development of knowledge, skills and competencies within a personal, social, civic or employment perspective.</p> <p>1.12. <b>ENIC/ NARIC Kosova</b> - States Center for Academic Recognition and Information. ENIC / NARIC Kosova, helps promote the mobility of students,</p>	<p>1.9. <b>Obezbeđivanje kvaliteta</b>-podrazumeva celinu politike, procesa i aktivnosti na državnom i institucionalnom nivou za obezbeđivanje i unapređenje kvaliteta u viskom obrazovanju. Obezbeđivanje kvaliteta takođe se odnosi na nastavu i učenje u viskom obrazovanju, uključujući i sredinu u kojoj se odvija nastava i veze sa naučnim istraživanjima i inovacijama;</p> <p>1.10. <b>Rezultati učenja</b> - ishodi učenja izraženi u pojmovima onoga što se od studenta očekuje da zna, razume i da bude u stanju da radi nakon završetka stepen studije ili modula. Tu može biti uključeni stavovi, ponašanje, vrednosti i etiku.</p> <p>1.11. <b>Celoživotno učenje</b> opšte obrazovanje, profesionalno obrazovanje i osposobljavanje, neformalno obrazovanje i neformalno učenje, stečeno tokom celog života, rezultirajući na razvoj znanja, veština i kompetencija u ličnoj, socijalnoj, građanskoj ili radnoj perspektivi.</p> <p>1.12. <b>ENIC/ NARIC Kosovar</b> - Državni centar za akademsko priznavanje i informisanje. ENIC / NARIC Kosovo, pomaže u promovisanju mobilnosti</p>
--	--	--

<p>së studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve, duke ofruar këshilla dhe informacione kompetente në lidhje me njohjen akademike të diplomave dhe të periudhës së studimeve, të ndërmarra në shtetet tjera.;</p> <p><b>1.13. Arsimi parauniversitar</b> - i referohet niveleve të shkollimit të rregulluar përmes legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar;</p> <p><b>1.14. Viti akademik</b>- fillon me 1 tetor dhe përfundon me 30 shtator të vitit vijues;</p> <p><b>1.15. Program i studimit</b> - program që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një institucion i arsimit të lartë, ashtu siç përcaktohet në vendimin për akreditim;</p> <p><b>1.16. Institucion i arsimit të lartë, në tesktin e mëtejme IAL</b> - çdo institucion i akredituar dhe i licencuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><b>1.17. Institucion publik i arsimit të lartë</b> - çdo institucion i arsimit të lartë, i themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i ratifikuar</p>	<p>teachers and researchers by providing competent advice and information regarding the academic recognition of diplomas and the period of study undertaken in other countries.;</p> <p><b>1.13. Pre-university education</b> - refers to the level of education regulated through the legislation in force for pre-university education.</p> <p><b>1.14. Academic year</b> - starts on October 1st and ends on September 30th of the following year;</p> <p><b>1.15. Study program</b> - a program leading to a qualification or diploma, awarded by a higher education institution, as defined in the accreditation decision;</p> <p><b>1.16. Higher education institution in further text HEI</b> - any institution accredited and licensed to provide educational services at the level of higher education, in accordance with legislation in force;</p> <p><b>1.17. Public institution of higher education</b> - any institution of higher education, established by a decision of the Government of the Republic of</p>	<p>studenata, nastavnika i istraživača pružajući kompetentne savete i informacije u vezi sa akademskim priznavanjem diploma i period studiranja izvedenim u drugim zemljama.;</p> <p><b>1.13. Preduniverzitetsko obrazovanje</b> - odnosi se na nivo obrazovanja regulisan zakonodavstvom na snazi za preduniverzitetsko obrazovanje;</p> <p><b>1.14. Akademska godina</b> - počinje 1. Oktobar, a završava 30. septembra naredne godine.</p> <p><b>1.15. Studijski program</b> - program koji vodi ka kvalifikaciji ili diplomiranju, koje dodeljuje određena institucija visokog obrazovanja, kao što je definisano u odluci o akreditaciji;</p> <p><b>1.16. Institucija visokog obrazovanja u daljem tekstu IVO</b> - svaka institucija akreditovana i licencirana za pružanje obrazovnih usluga na nivou visokog obrazovanja, u skladu sa važećim zakonom;</p> <p><b>1.17. Javna institucija visokog obrazovanja</b> - svaka institucija visokog obrazovanja, osnovana odlukom Vlade Republike Kosovo i ratifikovana u</p>
---	--	--

<p>nga Kuvendi i Republikës së Kosovës apo i themeluar me ligj të veçantë;</p> <p><b>1.18. Institucion privat i arsimit të lartë</b> – çdo institucion i arsimit të lartë, i themeluar si person juridik, përveç institucioneve të themeluara nga Qeveria apo me ligj të veçantë të Republikës së Kosovës;</p> <p><b>1.19. Institucioni i arsimit të lartë të partneritetit publiko-privat</b> - çdo institucion i arsimit të lartë, i themeluar në përputhje me legjislacionin për partneritet publiko-privat;</p> <p><b>1.20. Organ akreditues i njohur</b> – Agjencia e Kosovës për Akreditim, apo ndonjë organ i ngjashëm i cili aktualisht është i anëtarësuar me të drejta të plota në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë EQAR, ose nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara - USDE;</p> <p><b>1.21. Garancion financiar</b> - dokument financiar nga institucioni privat i arsimit të lartë, i cili garanton që shuma e mjeteve të tij është e mjaftueshme për të garantuar të drejtat ekonomike të studentëve që kanë bërë pagesën e</p>	<p>Kosova and ratified by the Assembly or established with a special law;</p> <p><b>1.18. Private institution of higher education</b> - any institution of higher education, established as a legal entity, except institutions established by the Government or by special law of the Republic of Kosova;</p> <p><b>1.19. Public-private partnership of higher education institution</b> - any institution of higher education established in accordance with the legislation on public-private partnerships.</p> <p><b>1.20. Recognized accreditation body</b> - Kosova Accreditation Agency, or a similar body which is currently a full member of the European Quality Assurance Register in Higher Education EQAR, or by the United States Department of Education - USDE.</p> <p><b>1.21. Financial guarantee</b> - a financial document from a private institution of higher education, which guarantees that the amount of its funds is sufficient to guarantee the economic rights of students who have paid tuition and are entitled to</p>	<p>Skupštini Republike Kosovo ili osnovana posebnim zakonom;</p> <p><b>1.18. Privatna institucija visokog obrazovanja</b> - svaka institucija visokog obrazovanja, osnovana kao pravni subjekat osim institucija osnovanih od strane Vlade ili posebnim zakonom Republika Kosovo;</p> <p><b>1.19. Institucija visokog obrazovanja javno-privatnog partnerstva</b> - svaka institucija visokog obrazovanja osnovana u skladu sa zakonodavstvom o javno-privatnom partnerstvu.</p> <p><b>1.20. Priznato akreditaciono telo</b> - Kosovska agencija za akreditaciju, ili slično telo koje je trenutno učlanjeno kao punopravni član Evropskog registra za obezbeđivanje kvaliteta u visokom obrazovanju EQAR, ili od strane Departament obrazovanja Sjedinjenih Država - USDE.</p> <p><b>1.21. Finansijska garancija</b> - finansijski dokument privatne vinstitucije visokog obrazovanja, koji garantuje da je iznos njenih sredstava dovoljan je da garantuje ekonomska prava studenata koji su platili školarinu i</p>
---	---	--

<p>shkollimit dhe kanë të drejtë të marrin arsimin që korrespondon me shumën e paguar;</p> <p>1.22. <b>Tarifat e studimit</b> - pagesat e studentëve të regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë që i cakton Ministria për një vit akademik;</p> <p>1.23. <b>Licencimi</b> - proces përmes të cilit Ministria zhvillon procedurën për dhënien e lejes zyrtare për institucionet e arsimit të lartë, bazuar në vlerësimin e programeve dhe institucioneve të akredituara nga AKA për të ushtruar veprimtarinë arsimore/akademike;</p> <p>1.24. <b>Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK)</b> - korniza që përmban të gjitha llojet dhe nivelet e kualifikimit të arsimit të lartë të cilat ofrohen në Kosovë dhe mënyrat e nxënies që shpiten në këto kualifikime. KKK-ja është në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) që përfshin katër (4) nivele të kualifikimit që i përkasin arsimit të lartë: niveli 5 (programet e shkurtra profesionale pas shkollimit të mesëm), 6 (niveli bachelor), 7 (niveli master) dhe 8 (niveli i doktoratës);</p>	<p>receive education corresponding to the amount payed.;</p> <p>1.22. <b>Tuition fees</b> - payments of students enrolled in public institutions of higher education assigned by the Ministry for an academic year.</p> <p>1.23. <b>Licensing</b> - a process through which the Ministry develops the procedure for granting official permission to higher education institutions, based on the evaluation of programs and institutions accredited by the KAA to exercise educational / academic activity;</p> <p>1.24. <b>National Qualifications Framework (NQF)</b> - the framework that contains all types and levels of higher education qualifications offered in Kosovo and the learning ways that lead to these qualifications. The NQF is in compliance to the European Qualifications Framework (EQF) which includes four (4) levels of qualifications pertaining to higher education: level 5 (short vocational programs after secondary education), 6 (bachelor level), 7 (master level) and 8 (doctoral level);</p>	<p>imaju pravo na školovanje u skladu sa uplaćenim iznosom.;</p> <p>1.22. <b>Tarifa školarine</b> - naknade za studente koje upisanih u javnim institucijaam visokog obrazovanja utvrđuje Ministarstvo za jednu akademsku godinu.</p> <p>1.23. <b>Licenciranje</b> - proces kroz koji Ministarstvo razvija proceduru za izdavanje zvanične dozvole institucijama visokog obrazovanja, na osnovu procene programa i institucija akreditovanih od strane KAA za obavljanje obrazovne/akademske delatnosti;</p> <p>1.24. <b>Nacionalni okvir kvalifikacija (NOK)</b> - okvir koji sadrži sve vrste i nivoe kvalifikacije visokog obrazovanja koje se nude na Kosovu i načine učenja koje dovodi do ovih kvalifikacija. NOK je u skladu sa Evropskim okvirom kvalifikacija (EOK) koji uključuje četiri (4) nivoe kvalifikacija koje se odnose na visoko obrazovanje: nivo 5 (kratki stručni programi nakon srednjeg obrazovanja), 6 (nivo bachelor), 7 (nivo master) i 8 (nivo doktorat);</p>
--	--	---



<p>1.25. <b>Studimet me korrespondencë</b>-organizohen për studentë të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune dhe të cilët kërkojnë që të vazhdojnë studimet me kohë jo të plotë jashtë orarit të rregullt mësimor. Për studimet me korrespondencë, IAL cakton orar të veçantë dhe të plotë sipas ngarkesës dhe planprogramit të përcaktuar, i cili mund të përfshijë edhe ditët e fundjavës;</p> <p>1.26. <b>Studimet në distancë</b>-nënkuptojnë procesin mësimor pa prezencë fizike brenda një ambienti mësimor të mësimdhënësve dhe studentëve, ndërsa vjen në shprehje përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve të ndryshme teknologjike që mundësojnë komunikimin e përbashkët dhe të dyanshëm elektronik audio-vizuel;</p> <p>1.27. <b>Sistemi për menaxhimin e informatave në arsimin e lartë (SMIAL)</b> - platformë elektronike për regjistrimin, grumbullimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe raportimin e të dhënave statistikore që shërbejnë si bazë për hartimin dhe monitorimin e politikave në arsimin e lartë;</p>	<p>1.25. <b>The correspondence studies</b> - are organized for students who are in full-time employment and who seek to continue their part-time studies outside of regular school hours. For correspondence studies, the HEI sets a special and full schedule according to the workload and the defined curriculum, which may also include weekends.</p> <p>1.26. <b>Distance studies</b> - means learning process without physical presence within a learning environment of teachers and students, while the use of various technological devices and tools that enable joint and two-way electronic audio-visual communication is expressed.;</p> <p>1.27. <b>Higher Education Information Management System (EMIS)</b> - an electronic platform for recording, collecting, storing, protecting and reporting statistical data that serve as a basis for drafting and monitoring policies in higher education.</p>	<p>1.25. <b>Vanredne studije</b> se - organizuju za studente koji su u redovnom radnom odnosu i koji žele da nastave studije ne sa punim vremenom vanredne nastave. Za vanredne studije, IVO uspostavlja poseban i pun raspored u skladu sa opterećenjem i definisanim nastavnim planom i programom, koji može uključivati i dani vikenda.</p> <p>1.26. <b>Učenje na daljinu</b> - podrazumeva nastavni proces bez fizičkog prisustva u nastavnom ambijentu nastavnika i studenata, međutim dozvoljava se upotreba različite tehnološke uređaje i alati koji omogućavaju zajedničku i dvosmernu elektronsku audio-vizuelnu komunikaciju.;</p> <p>1.27. <b>Sistem menadžiranje informacijama o visokom obrazovanju (SMIVO)</b> elektronska platforma za registraciju, prikupljanje, čuvanje, zaštitu i izveštavanje statističkih podataka koji služe kao osnova za izradu i praćenje politika u visokom obrazovanju</p>
--	--	--

<p>1.28. <b>Integritet akademik</b> – sjellja që siguron ruajtjen e ndershmërisë akademike, dinjitetit të profesionit, cilësisë së punës dhe produkteve të saj dhe respektimit të normave ligjore dhe etike nga ana e anëtarëve të komunitetit akademik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Parimet e arsimit të lartë</b></p> <p>1. Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në parimet vijuese:</p> <p>1.1. Liria, integriteti akademik dhe etika;</p> <p>1.2. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë;</p> <p>1.3. Barazia para ligjit, mundësi të barabarta, qasje gjithëpërfshirëse dhe jo diskriminim për të gjithë në AL dhe mësimin gjatë tërë jetës;</p> <p>1.4. Transparenca, përgjegjësia dhe llogaridhënia para publikut;</p> <p>1.5. Kohezioni në mes të veprimtarive arsimore, kërkimore-shkencore, inovacionit dhe kreativitetit artistik;</p>	<p>1.28. <b>Academic integrity</b> - behavior that ensures the preservation of academic honesty, the dignity of the profession, the quality of work and its products and the observance of legal and ethical norms by members of the academic community.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Principles of Higher Education</b></p> <p>1. The provision of higher education in the Republic of Kosova is based on the following principles:</p> <p>1.1. Freedom, academic integrity and ethics.</p> <p>1.2. Autonomy of higher education institutions.</p> <p>1.3. Equality before the law; equal opportunities, inclusive access and non-discrimination for all in HE and lifelong learning;</p> <p>1.4. Transparency, responsibility and accountability before the public.</p> <p>1.5. Cohesion between educational activities, scientific research, innovation and artistic creativity.</p>	<p>1.28. <b>Akademski integritet</b> – ponašanje koje obezbeđuje očuvanje akademskog poštenja, dostojanstva profesije, kvaliteta rada i njegovih proizvoda i poštovanje zakonskih i etičkih normi od strane članova akademske zajednice.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Principi visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Pružanje visokog obrazovanja u Republici Kosovo zasniva se na sledećim principima:</p> <p>1.1. Sloboda, akademski integritet i etika.</p> <p>1.2. Autonomija institucija visokog obrazovanja.</p> <p>1.3. Jednakost pred zakonom, jednake mogućnosti, inkluzivni pristup i nediskriminacija za sve u VO i celoživotno učenje.</p> <p>1.4. Odgovornost za transparentnost i odgovornost prema javnosti.</p> <p>1.5. Kohezija, između -obrazovnih, naučno-istraživački aktivnosti, inovacija i umetničke kreativnosti;</p>
--	---	--

<p>1.6. Mbrojtja e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e autorit;</p> <p>1.7. Zbatimi i standardeve të vlerësimit të cilat përmbajnë së paku minimumin e kriterëve të cilësisë që përdoren në hapësirën evropiane të AL.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Integriteti akademik</b></p> <p>1. Integriteti akademik bazohet në parimet e ndershmerisë, objektivitetit, transparencës, lirisë akademike dhe përgjegjësisë ndaj komunitetit akademik dhe shoqërisë.</p> <p>2. Komiteti etik është përgjegjës për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e integritetit akademik, si dhe për parandalimin e të gjitha formave të cenimit të integritetit akademik.</p> <p>3. Komiteti etik:</p> <p>3.1. Nxjerr dhe përcjellë zbatimin e Konventës etike;</p> <p>3.2. Nxitë respektimin e parimeve të integritetit akademik;</p>	<p>1.6. Intellectual property and copyright protection.</p> <p>1.7. Implementation of evaluation standards, which contain at least the minimum quality criteria used in the European HE area.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Academic integrity</b></p> <p>1. Academic integrity is based on the principles of honesty, objectivity, transparency, academic freedom and responsibility to the academic community and society.</p> <p>2. The Ethics Committee is responsible for preserving, protecting and promoting academic integrity, as well as for preventing all forms of breach of academic integrity.</p> <p>3. The Ethics Committee:</p> <p>3.1. Issue and monitor the implementation of the Ethics Convention;</p> <p>3.2. Promotes respect to the academic integrity principles;</p>	<p>1.6. Zaštita intelektualne svojine i autorskih prava.</p> <p>1.7. Primena standarda ocenjivanja koji sadrže najmanje minimalne kriterijume kvaliteta koji se koriste u evropskom prostoru VO.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Akademski integritet</b></p> <p>1. Akademski integritet zasniva se na principima poštenja, objektivnosti, transparentnosti, akademske slobode i odgovornosti prema akademskoj zajednici i društvu.</p> <p>2. Etički komitet je odgovoran za očuvanje, zaštitu i unapređenje akademskog integriteta, kao i za sprečavanje svih oblika narušavanja akademskog integriteta.</p> <p>3. Etički komitet;</p> <p>3.1. Izdaje i prati sprovođenje Etičke konvencije;</p> <p>3.2. Promoviše poštovanje principa akademskog integriteta;</p>
---	---	---

<p>3.3. Vendosë për shkeljet e supozuara të integritetit akademik për qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët kanë publikuar ose kanë fituar grada jashtë Republikës së Kosovës;</p> <p>3.4. Jep mendime dhe këshilla për çështje që kanë të bëjnë me integritetin akademik;</p> <p>3.5. Paraqet raportin vjetor për gjendjen e integritetit akademik në Republikën e Kosovës;</p> <p>3.6. Kryen edhe punë të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Anëtarët e Komitetit etik janë ekspertë me renome nga fusha e arsimit të lartë dhe emërohen nga Ministri.</p> <p>5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit etik, numri i anëtarëve dhe mënyra e emërimit dhe e shkarkimit të tyre rregullohen me akt nënligjor.</p> <p>6. IAL themelojnë këshillat e etikës të përcaktuara me statut.</p>	<p>3.3. Decide on alleged violations of academic integrity for citizens of the Republic of Kosovo who have published or obtained degrees outside the Republic of Kosovo;</p> <p>3.4. Provides opinions and advice on issues related to academic integrity;</p> <p>3.5. Presents the annual report on the state of academic integrity in the Republic of Kosovo;</p> <p>3.6. Conducts also other works in compliance with legislation in force.</p> <p>4. The members of the Ethics Committee are renowned experts in the field of higher education and are appointed by the Minister.</p> <p>5. The duties and responsibilities of the Ethics Committee, the number of members and the manner of their appointment and dismissal are regulated by a sub-legal act.</p> <p>6. HEIs establish ethics councils defined by statute.</p>	<p>3.3. Odlučuje o navodnim povredama akademskog integriteta za građane Republike Kosovo koji su objavili ili stekli diplome van Republike Kosovo;</p> <p>3.4. Daje mišljenja i savete o pitanjima vezanim za akademski integritet;</p> <p>3.5. Predstavlja godišnji izveštaj o stanju akademskog integriteta u Republici Kosovo;</p> <p>3.6. Obavlja druge poslove u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Članovi Etičkog odbora su renomirani stručnjaci iz oblasti visokog obrazovanja i imenuje ih ministar.</p> <p>5. Dužnosti i odgovornosti Etičke komisije, broj članova i način njihovog imenovanja i njihovog razrešavanja uređuju se podzakonskim aktom.</p> <p>6. IVO osnivaju etičke savete definisane statutom.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Objektivat e arsimit të lartë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Higher Education Objectives</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Ciljevi visokog obrazovanja</b></p>
<p>1. Objektivat e arsimit të lartë janë:</p> <p>1.1. Krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transferimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore dhe artistike;</p> <p>1.2. Përgatitja e studentëve për nevojat e tregut të punës, studime të mëtejshme, praktikë profesionale dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës;</p> <p>1.3. Sigurimi i bartjes së njohurive ndërmjet arsimit të lartë dhe ekonomisë;</p> <p>1.4. Nxitja e kreativitetit, inovacionit dhe ndërmarrësisë si faktorë kyç për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës;</p> <p>1.5. Kontributi në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe në prioritetet dhe interesat strategjike të vendit;</p>	<p>1. Higher Education Objectives are:</p> <p>1.1. Creation, development, protection and transfer of knowledge through teaching and scientific-research and artistic work.</p> <p>1.2. Preparing students for the needs of the labor market, further studies, professional practice and for lifelong learning.</p> <p>1.3. Ensuring knowledge transfer between higher education and the economy.</p> <p>1.4. Promoting creativity, innovation and entrepreneurship as a key factor for the development of higher education institutions and study programs, in line with the demands of the labor market;</p> <p>1.5. Contribution to economic, social and cultural development at national and international level and to the country's strategic priorities and interests;</p>	<p>1. Ciljevi visokog obrazovanja su:</p> <p>1.1. Stvaranje, razvoj, zaštita i prenos znanja kroz nastavnu i naučno-istraživački i umetnički rad;</p> <p>1.2. Pripremanje studenata za potrebe tržišta rada, dalje studije, profesionalnu praksu i celoživotno učenje.</p> <p>1.3. Obezbeđivanje prenosa znanja između visokog obrazovanja i ekonomije.</p> <p>1.4. Podsticaj kreativnosti, inovacija i preduzetništva kao ključnog faktora za razvoj institucija visokog obrazovanja i studijskih programa, u skladu sa zahtevima tržišta rada.</p> <p>1.5. Doprinos ekonomskom, socijalnom i kulturnom razvoju na nacionalnom i međunarodnom nivou i strateškim prioritetima i interesima zemlje.</p>

<p>1.6. Rritja e mobilitetit akademik të personelit mësimdhënës dhe studentëve;</p> <p>1.7. Nxitja e konkurrencës së drejtë në mes institucioneve të arsimit të lartë gjatë ofrimit të shërbimeve edukative-arsimore dhe atyre kërkimore-shkencore në nivel vendi me qëllim që të rritet cilësia dhe efikasiteti i sistemit të AL;</p> <p>1.8. Promovimi dhe mbështetja e angazhimit aktiv të studentëve në aspekte individuale dhe kolektive dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse të përcaktuara me këtë ligj dhe me statute të IAL.</p>	<p>1.6. Increasing the academic mobility of the teaching staff and students.</p> <p>1.7. Promoting competition between Higher Education Institutions during provision of upbringing-educational and scientific-research services at the national level in order to increase the quality and efficiency of the HE system;</p> <p>1.8. Promotion and support of active engagement of students in individual and collective aspects and participation in decision-making processes defined by this law and statutes of HEIs.</p>	<p>1.6. Povećavanje akademske mobilnosti nastavnog osoblja i studenata.</p> <p>1.7. Podsticaj konkurencije između institucija visokog obrazovanja tokom pružanja edukativno-obrazovnih i naučno-istraživačkih usluga na državnom nivou u cilju povećanja kvaliteta i efikasnosti sistema VO.</p> <p>1.8. Promovisanje i aktivno angažovanje studenata u individualnom aspektu i učešće u procesu donošenja odluka utvrđeno ovim zakonom i statutom IVO-a.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>E drejta në arsim</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Right to education</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Pravo na obrazovanja</b></p>
<p>1. Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, kanë të drejtë në arsimin e lartë, pa marrë parasysh gjininë, etninë, moshën apo çfarëdo përkatësie tjetër grupore, bazuar në kriteret e pranimit në institucionet e akredituara dhe licencuara në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. IAL-të, krijojnë kushte për qasjen në arsim për të gjithë studentët, duke marrë parasysh nevojat e tyre të veçanta, aftësinë e kufizuar apo nevojat tjera specifike të</p>	<p>1. All citizens of the Republic of Kosova have the right to higher education, regardless of gender, ethnicity, age or any other group affiliation, in accordance with the admission criteria in accredited and licensed institutions in the Republic of Kosova.</p> <p>2. HEIs create conditions for access to education for all students taking into account their special needs, disability or other specific needs of other social categories.</p>	<p>1. Svi građani Republike Kosovo imaju pravo na visoko obrazovanje, bez obzira na pol, etničku pripadnost, starost ili bilo koju drugu grupnu pripadnost, u skladu sa kriterijumima za prijem u akreditovanim i licenciranim institucijama u Republici Kosovo.</p> <p>2. IVO za stvaraju uslove za pristup obrazovanju za sve učenike uzimajući u obzir njihove posebne potrebe, ograničene sposobnosti ili druge specifične potrebe</p>

<p>kategorive të tjera sociale.</p> <p>3. IAL-të, ofrojnë kurrikula gjithëpërfshirëse, mësimdhënie që merr parasysh llojet e ndryshme të të nxëniet si dhe metoda të mësimdhënies dhe vlerësimit të përshtatshme për të gjithë studentët pa dallim.</p> <p>4. Pranimi i studentëve të huaj mund të kufizohet ose të refuzohet nëse studimi ka të bëjë me edukimin ushtarak, policor ose të një fushe me interes të sigurisë kombëtare.</p> <p>5. Qasje në arsimin e lartë në Kosovë, kanë të gjithë ata persona që u njihen dokumentet e shkollimit të fituara jashtë vendit.</p> <p>6. Arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt, me korrespondencë, përmes të mësuarit në prezencë ose distancë dhe me kombinim të cilësdo prej këtyre mënyrave të studimit, ashtu sikurse parashihet në statutin e institucionit gjegjës të arsimit të lartë.</p> <p>7. Aplikimi i masave afirmative për komunitetet joshumicë do të zbatohet në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, në pajtim me ndarjen e përgjithshme të kuotave për regjistrim. Ministria nxjerr udhëzime administrative mbi masat afirmative për regjistrimin e studentëve dhe masa</p>	<p>3. HEIs offer comprehensive curricula, teaching that takes into account different learning styles, as well as teaching and assessment methods suitable for all students with no difference.</p> <p>4. Admission of foreign students may be restricted or refused if the study is related to military, police education or a field of national security interest.</p> <p>5. Access to higher education in Kosovo have all those persons to whom the education documents obtained abroad are recognized.</p> <p>6. Higher education can be pursued on a regular basis, by correspondence, through face-to-face or distance learning and by a combination of any of these modes of study, as provided in the statute of the respective institution of higher education.</p> <p>7. The application of affirmative measures for non-majority communities will be applied in all public institutions of higher education in accordance with the general allocation of registration quotas. The Ministry issues administrative instructions on affirmative measures for student</p>	<p>drugih socijalnih kategorija.</p> <p>3. IVO za nude sveobuhvatne kurikulume, nastavu koja ima u uvid različita učenja, kao i metode nastave i ocenjivanja pogodne za sve studente bez razlike.</p> <p>4. Prijem stranih studenata može biti ograničen ili odbijen ako se studija odnosi na vojno, policijsko ili drugu oblasti nacionalne sigurnosti.</p> <p>5. Pristup visokom obrazovanju na Kosovu imaju sva lica kojima su im priznata dokumenta školovanja stečena na inostranstvu.</p> <p>6. Visoko obrazovanje se može pohađati redovno, vanredno, putem učenja u prisustvu ili učenja na daljinu i kombinacijom bilo kog od ovih načina studiranja, kako je predviđeno statutom odgovarajuće institucije visokog obrazovanja.</p> <p>7. Primena afirmativnih mera za nevećinske zajednice sprovodiće se u svim javnim institucijama visokog obrazovanja u skladu sa opštom raspodelom upisnih kvota. Ministarstvo izdaje administrativno uputstvo o afirmativnim merama za registraciju studenata i merama olakšice za</p>
---	---	---

<p>lehtësuese për grupe të marginalizuara.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>E drejta për përgatitjen e</b> <b>mësimdhënësve për nivelin</b> <b>parauniversitar</b></p> <p>Vetëm institucionet publike të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që çojnë në kualifikime për mësimdhënës në nivel parauniversitar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Korniza e kualifikimeve dhe ciklet e</b> <b>studimit në arsimin e lartë</b></p> <p>1. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) e Republikës së Kosovës, në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), është e organizuar në tetë (8) nivele të kualifikimit, prej të cilave nivelet 5 deri 8 korrespondojnë me arsimin e lartë.</p> <p>2. Niveli 5 korrespondon me llojet e ndryshme të cikleve të shkurtra të arsimit profesional, që normalisht zgjasin një (1) deri në dy (2) vite apo 60 deri në 120 ECTS kredi dhe që shpie në një certifikatë ose diplomë profesionale. Kreditë ECTS, të fituara gjatë këtyre studimeve mund të</p>	<p>registration and facilitating measures for marginalized groups.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>The right to prepare teachers</b> <b>for the pre-university level</b></p> <p>Only public institutions of higher education can offer study programs that lead to qualifications for teachers in pre-university level.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Qualifications framework and study</b> <b>cycles in higher education</b></p> <p>1. The National Qualifications Framework (NQF) of the Republic of Kosovo, in accordance with the European Qualifications Framework (EQF), is organized into eight (8) qualification levels, of which levels 5 to 8 correspond to higher education.</p> <p>2. Level 5 corresponds to different types of short cycles of vocational education or secondary education, which normally last one (1) to two (2) years or 60 to 120 ECTS credits and leading to a professional certificate or diploma. ECTS credits obtained during these studies can be transferred to the</p>	<p>marginalizovane grupe.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Pravo na pripremu nastavnika za</b> <b>preduniverzitetski nivo</b></p> <p>Samo javne institucije visokog obrazovanja mogu nuditi studijske programe koji vode do kvalifikacije za nastavnike preduniverzitetskog nivoa.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Kvalifikacioni okvir i ciklusi studija u</b> <b>visokom obrazovanju</b></p> <p>1. Nacionalni okvir za kvalifikacije (NOK) Republike Kosovo, u skladu sa Evropskim okvirom kvalifikacija (EOK), organizovan je na osam (8) nivoa kvalifikacija od kojih -ti do 8-mi nivo odgovaraju visokom obrazovanju.</p> <p>2. Nivo 5 odgovara različitim vrstama kratkih ciklusa profesionalnog obrazovanja, koji obično traju jednu (1) do dve (2) godine ili 60 do 120 ECTS kredita i vode do profesionalne certifikate ili diplome. ECTS krediti dobijeni tokom ovih studija mogu se preneti u prvi ciklus studija u skladu sa</p>
---	---	---



<p>barten në ciklin e parë të studimeve në përputhje me kriteret e përcaktuara nga institucioni i destinuar i arsimit të lartë.</p> <p>3. Niveli 6 korrespondon me ciklin e parë të studimeve, me kohëzgjatje ndërmjet tre (3) dhe katër (4) vite, gjatë të cilave kandidati fiton prej 180 deri 240 ECTS kredi dhe që shpie në llojet e ndryshme të titujve bachelor apo kualifikime ekuivalente. Kualifikimet e nivelit të 6 mund të pasqyrojnë studime akademike/shkencore ose programe me orientim profesional, të përshtatura kryesisht me nevojat e tregut të punës dhe inovacionet e aplikuara. Për regjistrim në studimet e ciklit të parë, kandidati duhet të ketë të përfunduara së paku dymbëdhjetë (12) vite shkollim parauniversitar (ose ekuivalente).</p> <p>4. Niveli 7 korrespondon me ciklin e dytë të studimeve, me kohëzgjatje një (1) deri në dy (2) vite gjatë të cilave kandidati fiton prej 60 deri 120 ECTS kredi dhe që shpie në llojet e ndryshme të titujve master apo kualifikimeve ekuivalente. Kualifikimet e nivelit të 7 mund të pasqyrojnë studime akademike/shkencore ose programe më të orientuara profesionale të përshtatura kryesisht me nevojat e tregut të punës dhe inovacionet e aplikuara. Për regjistrim në studimet e ciklit të dytë, kandidati duhet të ketë përfunduar nivelin e kualifikimit</p>	<p>first cycle of studies in accordance with the criteria set by the intended institution of higher education.</p> <p>3. Level 6 corresponds to the first cycle of studies, lasting between three (3) and four (4) years, during which the candidate earns from 180 to 240 ECTS credits and leads to various types of bachelor's degrees or equivalent qualifications. Level 6 qualifications may reflect academic / scientific studies or more professionally oriented programs, mainly adapted to the needs of the labor market and applied innovations. To enroll in first cycle studies, the candidate must have completed at least twelve (12) years of pre-university (or equivalent education).</p> <p>4. Level 7 corresponds to the second cycle of studies, with duration one (1) to (2) years, during which the candidate earns from 60 to 120 ECTS credits and leads to various types of Master degrees or equivalent qualifications. Level 7 qualifications may reflect academic / scientific studies or more professionally oriented programs, tailored primarily to the needs of the labor market and applied innovations. To enroll in second cycle studies, the candidate must have completed a bachelor's degree level or equivalent and must meet any additional</p>	<p>kriterijumima utvrđenim od strane namenjene institucije za visoko obrazovanje.</p> <p>3. Nivo 6 odgovara prvom ciklusu studija, koji traje između tri (3) i četiri (4) godine, tokom kojih kandidat zarađuje od 180 do 240 ECTS kredita i dovodi do različitih vrsta diploma ili ekvivalentnih kvalifikacija. Kvalifikacije nivoa 6 mogu odražavati akademske / naučne studije ili više profesionalno orijentisane programe, uglavnom prilagođene potrebama tržištu rada i primenjenim inovacijama. Za upis studije prvog ciklusa, kandidat mora da je završio najmanje dvanaest (12) godina preduniverzitetskog školovanja (ili ekvivalentno).</p> <p>4. Nivo 7 odgovara drugom ciklusu studija, u trajanju od jedne (1) do dve (2) godine, tokom kojih kandidat stiče od 60 do 120 ECTS i dovodi do različitih vrsta magistarskih diploma ili ekvivalentnih kvalifikacija. Kvalifikacije nivoa 7 mogu odražavati akademske / naučne studije ili više profesionalno orijentisane programe, uglavnom prilagođene potrebama tržištu rada i primenjenim inovacijama. Za upis drugog ciklusa studije, kandidat mora da ima završeni nivo kvalifikacije bachelor ili ekvivalentno tome i mora ispuniti sve</p>
---	--	---

<p>baçelor ose ekuivalent me të dhe duhet të plotësojë çdo kriter shtesë që kërkohet për praninë në programe apo institucione të caktuara. Niveli 7 i kualifikimeve, mund gjithashtu të organizohet në formë të programeve të integruara të studimit, të ciklit të parë dhe të dytë prej të paktën 300 ECTS kredi, në fusha specifike siç janë: mjekësia, stomatologjia, farmacia apo veterinarja si dhe programet tjera të integruara.</p> <p>5. Niveli 8 korrespondon me ciklin e tretë të studimeve, me kohëzgjatje normale prej jo më pak se tre (3) vite ose 180 ECTS kredi dhe që shpie në titullin e doktorit të shkencave ose një lloj tjetër të kualifikimeve të doktoratës. Programet e ciklit të tretë kërkojnë hulumtime të pavarura akademike/shkencore në një nivel më të avancuar. Për regjistrim në studimet e ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë fituar titullin “Master i shkencave”, “Master i arteve”, ose ekuivalente.</p> <p>6. Gradat, diplomat dhe certifikatat që i`u lëshohen studentëve me rastin e përfundimit të një programi të studimit i përmbushin kërkesat si në vijim:</p> <p>6.1. Të jenë në përputhje me formatin e përcaktuar nga Ministria;</p> <p>6.2. Të shoqërohen me shtojcën e</p>	<p>criteria required for admission to certain programs or institutions. Level 7 qualifications can also be organized in the form of integrated study programs, of first and second cycle of at least 300 ECTS credits, in specific fields such as: medicine, dentistry, pharmacy or veterinary as well as other integrated programs.</p> <p>5. Level 8 corresponds to the third cycle of studies, with a normal duration not less than three (3) years or 180 ECTS credits and leading to a PhD title or other type of doctoral qualifications. Third cycle programs require independent academic / scientific research at a more advanced level. To enroll in third cycle studies, the candidate must have earned the title “Master of sciences”, “Master of arts”, or equivalent.</p> <p>6. Degrees, diplomas and certificates issued to students upon completion of a study program meet the following requirements:</p> <p>6.1. To be in accordance with the format determined by the Ministry;</p> <p>6.2. To be accompanied by the diploma</p>	<p>dodatne kriterijume potrebne za prijem u određene programe ili institucije. Kvalifikacije 7. nivoa takođe mogu se organizovati i u vidu integrisanih studijskih programa, prvog i drugog ciklusa od najmanje 300 ECTS bodova, u određenim oblastima kao što su: medicina, stomatologija, farmacija ili veterina kao i drugi integrisani programi..</p> <p>5. Nivo 8 odgovara trećem ciklusu studija, sa normalnim trajanjem ne manje od tri (3) godine ili 180 ECTS kredita i koje vode do zvanje doktor nauka ili druge vrste doktorske kvalifikacije. Programi trećeg ciklusa zahtevaju nezavisno akademsko / naučno istraživanje na naprednijem nivou. Da bi se upisao na studije trećeg ciklusa, kandidat mora steći zvanje "Master nauka", ili ekvivalentno tome.</p> <p>6. Grade, diplome i sertifikati izdati studentima nakon završetka studijskog programa koji ispunjavaju sledeće zahteve:</p> <p>6.1. moraju biti u skladu sa formatom koji odredi Ministarstvo;</p> <p>6.2. u prilogu imati dodatak diplomi,</p>
--	--	--

<p>2.3. Të zgjedhin dhe gradojnë mësimdhënësit, hulumtuesit dhe personelin tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>2.4. Të përcaktojnë kushtet dhe kriteret për pranimin e studentëve;</p> <p>2.5. Të vendosin sistemin e tyre të brendshëm për sigurim të cilësisë, përfshirë edhe ato që lidhen me vlerësimin e mësimdhënësve dhe studentëve;</p> <p>2.6. Të hartojnë dhe zbatojnë kurrikulat akademike dhe projektet e kërkimeve shkencore, në konsultim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë;</p> <p>2.7. T'ijapin tituj stafit akademik, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi. Këto kriteret përcaktohen më hollësisht me statutin e institucionit;</p> <p>2.8. Të vendosin për mundësitë e transfereve për mobilitetin e studentëve, duke marrë parasysh standardet për transferim të ECTS krediteve;</p> <p>2.9. Të përcaktojnë masat disiplinore për personelin akademik sipas ligjit,</p>	<p>2.3. To select and rank teachers, researchers and other staff, in accordance with the legislation in force;</p> <p>2.4. To determine the conditions and criteria for student admission;</p> <p>2.5. To establish their own internal quality assurance system, including those related to teacher and student assessment;</p> <p>2.6. To compile and implement academic curricula and research projects, in consultation with local and international partners;</p> <p>2.7. To give titles to the academic staff, in accordance with this law and the legislation in force. These criteria are defined in more detail by the statute of the institution;</p> <p>2.8. To decide on transfer opportunities for student mobility, taking into account the standards for the transfer of ECTS credits;</p> <p>2.9. To determine the disciplinary measures for the academic staff according</p>	<p>2.3. Da odabere i gradira nastavnike, istraživače i drugo osoblje, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>2.4. Da odredi uslove i kriterijume za prijem studenata;</p> <p>2.5. Da uspostaviti sopstveni sistem za obezbeđivanje kvaliteta, uključujući i one koji se odnose na evaluaciju nastavnika i studenata;</p> <p>2.6. Da izradi i primeni akademske kurikulume i projekte naučnog istraživanja, uz konsultacije sa lokalnim i međunarodnim partnerima;</p> <p>2.7. Da dodeli zvanja akademskom osoblju, u skladu sa ovim zakonom i važećim zakonodavstvom. Ovi kriterijumi su detaljnije definisani statutom institucije;</p> <p>2.8. Da odluče o mogućnostima prenosa za mobilnost studenata, uzimajući u obzir standarde ECTS prenosa kredita;</p> <p>2.9. Da odrede disciplinske mere za akademsko osoblje u skladu sa zakonom,</p>
--	--	---

<p>statutit dhe akteve të tjera të institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>3. Për arritjen e shkathtësive dhe njohurive praktike në kuadër të programeve specifike të studimit, institucionet e arsimit të lartë mund të themelojnë njësi të veçanta organizative apo të realizojnë ato pjesë të programeve të studimit në institucione partnere.</p> <p>4. Institucionet publike të arsimit të lartë ruajnë neutralitetin politik dhe laicizmin, brenda mjediseve të tyre, nuk mund të zhvillohen veprimtari partiake ose religjioze.</p> <p>5. Institucioni publik i arsimit të lartë lirohet nga të gjitha format e tatimeve për veprimtaritë e tij mësimore dhe kërkimore-shkencore, të cilat financohen nga burime publike apo donacione, përveç rasteve që lidhen me veprimtari fitimprurëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë Ligj dhe në dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të tij, çdo institucion publik i arsimit të lartë, ka gjithashtu edhe të drejtën të:</p>	<p>to the law, the statute and other acts of the higher education institutions.</p> <p>3. In order to achieve practical skills and knowledge within specific study programs, higher education institutions may establish separate organizational units or carry out those parts of study programs in partner institutions.</p> <p>4. Public institutions of higher education maintain political neutrality and secularism, within their premises, no party or religious activities can take place.</p> <p>5. The public institution of higher education is exempt from all forms of taxes for its teaching and research activities, which are financed from public or donated sources, except in cases related to profitable activities in accordance with legislation in force.</p> <p>6. With the exception of the cases defined in this Law and in the additional documents issued on the basis of it, every public institution of higher education also, has the right to:</p>	<p>statutom i drugim aktima institucija visokog obrazovanja.</p> <p>3. Za postizanje praktične veštine i znanja u okviru određenih studijskih programa, institucije visokog obrazovanja mogu osnovati zasebne organizacione jedinice ili izvode delove studijskih programa u partnerskim institucijama.</p> <p>4. Javne institucije visokog obrazovanja održavaju političku neutralnost i sekularizam, u svojim ambijentima , ne mogu odvijati stranačke ili verske aktivnosti.</p> <p>5. Javna institucije visokog obrazovanja oslobađa se od svih oblika poreza za svoje nastavne i naučno-istraživačke aktivnosti, koji se finansiraju iz javnih ili doniranih sredstava, osim u slučajevima odnose koji se odnose se na profitabilne aktivnosti u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>6. Izuzev slučajeva definisanih ovim zakonom i dodatnim dokumentima izdatim na osnovu njega, svaka javna institucija visokog obrazovanja takođe , ima pravo da:</p>
---	--	--

<p>6.1. Zotërojë dhe menaxhojë tokën, ndërtesat dhe pasuri të tjera kapitale në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>6.2. Pranojë dhe administrojë fonde nga cilido lloj burimi i ligjshëm kombëtar apo i huaj, në përputhje me misionin e tij akademik dhe kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe çfarëdo statuti të ndërlidhur;</p> <p>6.3. Propozojë tek ministri tarifat e shërbimeve dhe studimeve për aprovim të mëtejshëm;</p> <p>6.4. Themelojë dhe ndërpresë marrëdhënien e punës së personelit akademik dhe kuadrit tjetër si dhe të ushtrisë të gjitha detyrat e një punëdhënësi, siç është paraparë me legjislacionin në fuqi;</p> <p>6.5. Lidhë kontrata për blerjen e mallrave dhe shërbimeve dhe investime kapitale;</p> <p>6.6. Krijojë marrëdhënie kontraktuale me studentët;</p> <p>6.7. Themelojë ndërmarrje komerciale për qëllime arsimore dhe hulumtuese;</p>	<p>6.1. To own and manage the land, buildings and other capital assets in accordance with legislation in force.</p> <p>6.2. Receive and administer funds from any legal national or foreign source, in accordance with its academic mission and the conditions set forth in this law and any related statute;</p> <p>6.3. Proposes to the Minister the fees for services and studies for further approval;</p> <p>6.4. Establishes and terminate the employment relationship of academic staff and other staff as well as exercise all the duties of an employer, as provided by the legislation in force;</p> <p>6.5. Concludes contracts for the purchase of goods and services and capital investments;</p> <p>6.6. Creates contractual relationships with students;</p> <p>6.7. Establishes commercial enterprises for educational and research purposes;</p>	<p>6.1. Poseduju i upravljaju zemljištem, zgradama i drugom kapitalnom imovinom u skladu sa važećim zakonom.</p> <p>6.2. Prima i upravlja sredstvima iz bilo kog zakonskog domaćeg ili međunarodnog izvora, u skladu sa svojom akademskom misijom i uslovima utvrđenim ovim zakonom i bilo kojim povezanim statutom;</p> <p>6.3. Predlaže ministru naknade za usluge i studije na dalje odobrenje;</p> <p>6.4. Uspostavi i prekine radni odnos akademskog osoblja i drugog osoblja, kao i obavlja sve dužnosti poslodavca, kako je predviđeno važećim zakonom;</p> <p>6.5. Zaključuje ugovore o kupovini robe i usluge i kapitalnih investicija;</p> <p>6.6. Stvara ugovorni odnos sa studentima;</p> <p>6.7. Osniva komercijalna preduzeća u svrhu obrazovanja i istraživanja;</p>
--	---	---

<p>6.8. Nënshkruaj marrëveshje me institucionet tjera në Republikën e Kosovës dhe me institucione ndërkombëtare.</p> <p>7. Me kusht të plotësisht të kërkesave sipas ligjit në fuqi, autoritetet publike përkatëse mund t'i japin një institucioni publik të arsimit të lartë, të drejtën e shfrytëzimit të truallit, ndërtesave apo pajisjeve që janë pronë publike dhe shoqërore.</p> <p>8. Një institucion publik i arsimit të lartë, i cili shfrytëzon truallin, ndërtesat apo pajisjet që janë pronë publike ose shoqërore nuk mund ta shesë atë ose t'ia jap dikujt të drejtat pronësore të kësaj prone. Një institucion publik i arsimit të lartë, i cili ka në shfrytëzim një pronë publike ose shoqërore, mund ta jep me qira këtë pronë, sidoqoftë, me kusht që më parë të ketë marrë miratimin formal nga autoriteti publik i cili e ka dhënë në shfrytëzim këtë pronë para se të jepet prona me qira. Nëse jepet ky miratim, autoriteti publik përcakton kushtet për shfrytëzimin e të ardhurave nga kjo pronë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Statuti i institucionit publik të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Statuti i institucionit publik të arsimit të lartë, përmban normat bazë që rregullojnë</p>	<p>6.8. Signs agreements with other institutions in the Republic of Kosovo and with international institutions.</p> <p>7. Provided that the requirements under the law in force are met, the relevant public authorities may grant to a public institution of higher education the right to use land, buildings or equipment that are public and socially owned property.</p> <p>8. A public institution of higher education that uses land, buildings or equipment that is public or socially owned may not sell it or give anyone the property rights to that property. A public institution of higher education, which has in use a public or socially owned property, may lease this property, however, provided that it has previously obtained the formal approval of the public authority which has given use of this property before the property is leased. If this approval is given, the public authority determines the conditions for the use of the income from this property.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Statute of the private higher education institutions</b></p> <p>1. The statute of public higher education institution contains the basic norms that</p>	<p>6.8. Potpisuje sporazume sa drugim institucijama u Republici Kosovo i sa međunarodnim institucijama.</p> <p>7. Pod uslovom da su ispunjeni zahtevi prema važećem zakonu, nadležni javni organi mogu javnoj instituciji visokog obrazovanja da dodele pravo na korišćenje zemljišta, zgrada ili opreme koja je u javnom i društvenom vlasništvu.</p> <p>8. Javna institucija visokog obrazovanja koja koristi zemljište, zgrade ili opremu a koje su u javnom ili društvenom vlasništvu ne može prodati isto niti dati bilo kome imovinska prava na toj imovini. Javna institucija visokog obrazovanja, koja koristi javnu ili društvenu imovinu, može ovu imovinu dati pod zakup, pod uslovom da je prethodno dobila formalno odobrenje od javnog organa koji je dao na korišćenje ovu imovinu pre nego što se imovina da u zakup. Ako se da odobrenje, javni organ utvrđuje uslove za korišćenje prihoda od ove imovine</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Statut javne institucije visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Statut javne institucije visokog obrazovanja, sadrži osnovne norme koje</p>
--	--	---

<p>veprimtarinë e tij dhe që përfshijnë dispozita që garantojnë lirinë akademike të personelit mësimdhënës dhe të studentëve, siç përshkruhet tutje në këtë Ligj.</p> <p>2. Statuti i institucionit publik të arsimit të lartë duhet të aprovohet nga Senati dhe i dërgohet Ministrisë për shqyrtim dhe miratim. Më pas përmes Ministrisë, procedohet për miratim në qeveri dhe kuvend.</p> <p>3. Ndryshimet në statut hartohen dhe miratohen me të njëjtat procedura të përcaktuara në paragrafin paraprak.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Konferenca e rektorëve</b></p> <p>1. Konferenca e rektorëve është organ kolegjal i pavarur i rektorëve të universiteteve publike i cili:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Nxitë bashkëpunimin në mes të universiteteve anëtare;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Jep rekomandime lidhur me çështje të arsimit të lartë me interes kombëtar.</p> <p>2. Konferenca e rektorëve punon në bazë të Rregullores së Punës të miratuar prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të saj.</p>	<p>regulate its activity and that include provisions that guarantee the academic freedom of the teaching staff and students, as further described in this Law.</p> <p>2. The statute of public higher education institution must be approved by the Senate and sent to the Ministry for review and approval. Then, through the Ministry is proceeded for approval at the government and the assembly.</p> <p>3. Amendments to the statute are drafted and approved by the same procedures set out in the previous paragraph.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Rectors conference</b></p> <p>1. The Rectors conference is a collegial, independent body of rectors of public universities, which:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Promotes cooperation between member universities;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Makes recommendations on higher education issues of national interest.</p> <p>2. The rectors conference works in basis of the work regulation approved from two third (2/3) of its members.</p>	<p>regulišu njegovu delatnost i koje uključuju odredbe koje garantuju akademsku slobodu nastavnog osoblja i studenata, kao što se dalje opisuje u ovom zakonu.</p> <p>2. Statut javne institucije visokog obrazovanja usvaja Senat i šalje Ministarstvu na razmatranje i usvajanje. Zatim se preko Ministarstva procesuirá se na odobrenje u vladi i skupštini.</p> <p>3. Izmene statuta izrađuju se i odobravaju istim postupcima utvrđenim u prethodnom paragrafu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Rektorska konferencija</b></p> <p>1. Rektorska konferencija je kolegijalno, nezavisno telo rektora javnih univerziteta koja:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1 Podstiče saradnju među univerzitetima članicama,</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2 Daje preporuke o pitanjima visokog obrazovanja od nacionalnog interesa.</p> <p>2. Rektorska konferencija radi na osnovu Poslovnika o radu koji usvaja dve trećine (2/3) njenih članova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 22</b></p>
--	---	---



<p align="center"><b>Neni 22</b> <b>Organet kryesore të strukturës qeverisëse</b></p>	<p align="center"><b>Article 22</b> <b>The main bodies of the governing structure</b></p>	<p align="center"><b>Glavni organi upravljačke strukture</b></p>
<p>1. Organet kryesore të strukturës qeverisëse të institucionit publik të arsimit të lartë janë:</p> <p>1.1. Senati;</p> <p>1.2. Këshilli drejtues;</p> <p>1.3. Rektori.</p> <p>2. Në statutet e tyre, institucionet mund të përvetësojnë emërtime të veçanta për secilin nga këto organe.</p> <p>3. Institucionet publike të arsimit të lartë që nuk e kanë statusin e universitetit apo kolegjit, mund të përjashtohen nga rregullat e përcaktuara në këtë nen, paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3, neni 24, 25 dhe neni 26 lidhur me strukturën e organeve dhe jo domosdoshmërisht duhet t'i përmbahen të njëjtës strukturë të organeve sikur institucionet publike të arsimit të lartë.</p> <p>4. Institucionet e arsimit të lartë, brenda strukturës së vet organizative kanë edhe organe të tjera të cilat i përcaktojnë me Statut.</p>	<p>1. Main bodies of the governing structure of the private higher education institutions are:</p> <p>1.1. Senate</p> <p>1.2. Steering council;</p> <p>1.3. Rector.</p> <p>2. In their statute, the institutions can acquire special designations for each of this bodies.</p> <p>3. Public institutions of higher education that do not have the status of University or College, can be exempted from the rules set out in this Article, paragraph 1.1, 1.2 and 1.3, Article 24, 25 and Article 26 regarding the structure of bodies and do not necessarily have to adhere to the same structure of bodies as public institutions of higher education.</p> <p>4. Higher education institutions, within their organizational structure have also other bodies which are defined by the Statute.</p>	<p>1. Glavna tela upravne strukture javne institucije visokog obrazovanja su:</p> <p>1.1. Senat.</p> <p>1.2. Upravni odbor;</p> <p>1.3. Rektor</p> <p>2. U svom statutu institucije mogu da usvoje posebna imena za svako od ova tela.</p> <p>3. Javne institucije visokog obrazovanja koje nemaju status univerziteta ili koledža, mogu biti izuzete od pravila utvrđenih u ovom članu stav 1.1, 1.2 i 1.3, člana 24, 25 i člana 26 u vezi strukturu organa i nije nužno da se pridržavaju iste strukture tela kao i javne institucije visokog obrazovanja.</p> <p>4. Institucije visokog obrazovanja, unutar svoje organizacione strukture imaju i ostala tela koja određuju Statutom.</p>

<b>Neni 23 Senati</b>	<b>Article 23 Senate</b>	<b>Član 23 Senat.</b>
<p>1. Senati është organi kryesor akademik dhe shkencor i institucionit publik të arsimit të lartë.</p> <p>2. Numri i anëtarëve të senatit caktohet me statutin e institucionit.</p> <p>3. Senati kryesohet nga kryetari i Senatit që zgjedhet nga anëtarët e Senatit me vota të fshehta.</p> <p>4. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Senatit janë:</p> <p>4.1. Mbron autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike si dhe të drejtat e personelit akademik dhe studentëve;</p> <p>4.2. Harton dhe aprovon statutin e institucionit të arsimit të lartë;</p> <p>4.3. Zgjedh anëtarët e Këshillit drejtues që propozohen nga institucioni;</p> <p>4.4. Harton dhe përcjell listën e kandidatëve për rektor tek Këshilli drejtues me së paku 3 kandidatë;</p>	<p>1. The Senate is the main academic and scientific body of the public institution of higher education.</p> <p>2. The number of the senate members is determined by the statute of the institution.</p> <p>3. The Senate is chaired by the President of the Senate who is elected by the members of the Senate by secret ballot</p> <p>4. The main duties and responsibilities of the Senate are:</p> <p>4.1. Protects the autonomy of the higher education institution, academic freedom, as well as the rights of academic staff and of students;</p> <p>4.2. Drafts and approves the statute of the higher education institution;</p> <p>4.3. Elects members of the Steering Council that are proposed by the institution;</p> <p>4.4. Compiles and forwards the list of candidates for the Rector to the Steering Council with at least 3 candidates;</p>	<p>1. Senat je glavno akademsko i naučno telo javne institucije visokog obrazovanja.</p> <p>2. Broj članova senata određuje se statutom institucije.</p> <p>3. Senatom predsedava predsednik Senata kojeg biraju članovi Senata tajnim glasanjem</p> <p>4. Glavne dužnosti i odgovornosti Senata su:</p> <p>4.1. Štiti autonomiju institucije visokog obrazovanja, akademsku slobodu, kao i prava akademskog osoblja i studente;</p> <p>4.2. Izrađuje i usvaja statut institucije visokog obrazovanja;</p> <p>4.3. Bira članove Upravnog odbora koje predlaže institucija;</p> <p>4.4. Sastavlja i prosleđuje listu kandidata za rektora Upravnom odboru sa najmanje 3 kandidata;</p>

<p>4.5. Aprovon apo refuzon propozimet e Fakulteteve dhe të Instituteve Kërkimore – Shkencore për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-të institucionit;</p> <p>4.6. Themelon komisione të nevojshme për funksionimin e Senatit; detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve përcaktohen në Statutin e institucionit;</p> <p>4.7. Harton politika zhvillimore akademike në bashkëpunim me rektorin;</p> <p>4.8. Miraton rregullore dhe akte tjera të brendshme nga fushëveprimi i vet, në lidhje me funksionimin e universitetit dhe njërive akademike, çështjet akademike dhe të programeve akademike në harmoni me planin strategjik;</p> <p>4.9. Miraton hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e njërive akademike si dhe të instituteve kërkimore shkencore; programeve studimore dhe kërkimore-shkencore në përputhje me planin strategjik dhe buxhetin e institucionit, duke marrë parasysh propozimin e njësisë akademike përkatëse dhe të instituteve kërkimore shkencore;</p>	<p>4.5. Approves or rejects the proposals of the Faculties and Research-Scientific Institutes for election, re-election and promotion of the academic and research staff of the institution;</p> <p>4.6. Establishes necessary commissions for the functioning of the Senate; duties and responsibilities of the commissions are defined in the Statute of the Institution;</p> <p>4.7. Compiles academic development policies in cooperation with rector;</p> <p>4.8. Approves regulations and other internal acts regarding from its scope, regarding the functioning of the university and the academic units, academic issues and academic programs in harmony with strategic plan.</p> <p>4.9. Approves opening, re-organization and closure of the academic units and of scientific research institutions; and scientific-research and study programs in compliance with the strategic plan and the budget of the institution, taking into consider the proposal of the relevant academic unit;</p>	<p>4.5. Odobrava ili odbija predloge fakulteta i Naučno-istraživačkih instituta za izbor, reizbor i unapređenje akademskog i naučno istraživačkog osoblja institucije;</p> <p>4.6. Osniva potrebne komisije za funkcionisanje Senata; dužnosti i odgovornosti komisija definišu se statutom institucija;</p> <p>4.7. Sastavlja razvojne akademske politike u saradnji sa rektorom;</p> <p>4.8. Usvaja propise i druge interne akte koji se odnose na funkcionisanje Univerziteta i akademskih jedinica, akademska pitanja i akademske programe u skladu sa strateškim planom.</p> <p>4.9. Odobrava otvaranje, reorganizaciju i zatvaranje akademskih jedinica kao i naučno-istraživačkih institucija; studijskih i naučno istraživačkih programa u skladu sa strateškim planom i budžetom institucije, uzimajući u obzir predlog odgovarajuće akademske jedinice i naučno-istraživačkih instituta;</p>
---	---	--

<p>4.10. Miraton planin vjetor aktivitetet akademike dhe kërkimore-shkencore/ artistike në kuadër të njësive akademike dhe të instituteve shkencore;</p> <p>4.11. Propozon kriteret për pranimin dhe regjistrimin e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të institucionit;</p> <p>4.12. Vendosë për procedurën disiplinore ndaj studentëve dhe mësimdhënësve;</p> <p>4.13. Shqyrton çështjet me kërkesë të Këshillit drejtues, rektorit dhe kërkesat tjera që vijnë në Senat;</p> <p>4.14. Ndërmerr masa konkrete për sigurimin e cilësisë në institucion;</p> <p>4.15. Kryen detyra dhe përgjegjësi tjera që përcaktohen me statutin e institucionit.</p> <p>5. Funkcionet tjera të Senatit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>6. Nuk mund të jenë anëtarë të Senatit zyrtarët të cilët janë të emëruar në pozita drejtuese në institucionin publik të arsimit të lartë.</p>	<p>4.10. Approves the annual plan of academic and research-scientific / artistic activities within the academic units and scientific institutes;</p> <p>4.11. Proposes criteria for admission and enrollment of students, in compliance with the legislation in force and internal acts of the institution;</p> <p>4.12. Decides about disciplinary procedure toward students and teachers;</p> <p>4.13. Examines issues at the request of the Steering Council, rector and other requests coming from the Senate;</p> <p>4.14. Undertakes concrete measures for quality assurance in the institution;</p> <p>4.15. Performs other duties and responsibilities defined by the statute of the institution.</p> <p>5. Other functions of the Senate are defined in the statute of the institution of higher education.</p> <p>6. Officials who are appointed to leading positions in the public institution of higher education cannot be members of the Senate.</p>	<p>4.10. Odobrava godišnji plan akademskih aktivnosti i naučno-istraživačke/umetničke u okviru akademskih jedinica i naučnih institucija;</p> <p>4.11. Predlaže kriterijume za prijem i registraciju studenata, u skladu sa važećem zakonodavstvu u internih akata institucije;</p> <p>4.12. Odlučuje o disciplinskom postupku protiv studenata i nastavnika;</p> <p>4.13. Razmatra pitanja na zahtev Upravnog odbora, rektora i drugih zahteva koji dolaze u Senat;</p> <p>4.14. Preduzima konkretne mere za obezbeđivanje kvaliteta u instituciji;</p> <p>4.15. Obavlja i druge dužnosti i odgovornosti definisane statutom institucije.</p> <p>5. Ostale funkcije Senata definišu se statutom institucije visokog obrazovanja.</p> <p>6. Ne mogu biti članovi Senat službenici koji su imenovani na rukovodeća mesta u javnim institucijama visokog obrazovanja ..</p>
--	--	---

<p>7. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga radha e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në institucion dhe studentëve. 15% e anëtarëve të Senatit me të drejtë vote duhet të jenë nga radhët e studentëve.</p> <p>8. Mandati i anëtarëve akademikë të Senatit është katër (4) vite. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një (1) vit, pa të drejtë të rizgjedhjes. Mandati i anëtarëve të Senatit fillon me vitin e ri akademik përkatës.</p> <p>9. Numri dhe mënyra e zgjedhjes, shkarkimit dhe zëvendësimit të anëtarëve të Senatit të cilëve u ka pushuar mandati rregullohet me statutin dhe rregulloret e institucionit.</p> <p>10. Senati mbledhet periodikisht dhe mund të marrë vendime në mbledhje ku marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit me të drejtë vote. Vendimi merret me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve të tjera kur përcaktohet ndryshe me statutin e institucionit.</p>	<p>7. Senate members are elected from among academic staff and students in full-time employment in the institution. 15% of the members of the Senate with the right to vote must be from among the students.</p> <p>8. The term of the academic members of the Senate is four (4) years. The term of the members from the ranks of students is one (1) year, without the right of re-election. The term of the Senate members begins with the respective new academic year.</p> <p>9. The number and manner of election, dismissal and replacement of members of the Senate whose term of office has been terminated is regulated by the statute and regulations of the institution.</p> <p>10. The Senate meets periodically and may take decisions in meetings attended by more than half of the total number of voting members of the Senate. The decision is taken by a majority vote of the members present, unless otherwise provided by the statute of the institution.</p>	<p>7. Članovi senata biraju se i redova akademskog osoblja stalnog radnog odnosa u instituciji i studenata. 15% članova Senata sa pravom glasa mora da budu iz redova studenata.</p> <p>8. Mandat akademskih članova Senata traje četiri (4) godine. Mandat članova iz redove studenata traje (1) godinu dana, bez prava na reizbor. Mandat članova Senata počinje odgovarajućom novom akademskom godinom.</p> <p>9. Broj i način izbora, razrešenja i zamene članova Senata kojima je istekao mandat reguliše se statutom i propisima institucije.</p> <p>10. Senat se sastaje povremeno i može donositi odluke na sastancima na kojima prisustvuje više od polovina ukupnog broja članova Senata sa pravom glasa. Odluka se donosi većinom glasova prisutnih članova, osim kada bude drugačije određeno statutom institucije.</p>
---	--	---

<p align="center"><b>Neni 24</b> <b>Këshilli drejtues</b></p>	<p align="center"><b>Article 24</b> <b>Steering council</b></p>	<p align="center"><b>Član 24</b> <b>Upravni odbor</b></p>
<p>1. Këshilli drejtues është organ mbikëqyrës dhe përgjegjës për çështje strategjike dhe buxhetore të institucionit publik të arsimit të lartë.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit drejtues janë:</p> <p>2.1. Të aprovojë planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe të mbikëqyrë zbatimin e tij;</p> <p>2.2. Të aprovojë planin financiar, buxhetin dhe llogaritë vjetore të audituara të institucionit;</p> <p>2.3. Të aprovojë dhe mbikëqyrë qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;</p> <p>2.4. T'i raportojë Ministrisë për realizimin e planit strategjik vjetor më së largu deri më 31 mars të vitit të ardhshëm;</p> <p>2.5. Të shpallë konkursin dhe zgjedhë rektorin, sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e institucionit;</p>	<p>1. The Steering Council is a supervisory body responsible for strategic and budgetary issues of the public institution of higher education.</p> <p>2. The duties and responsibilities of the Steering Council are:</p> <p>2.1. To approve the strategic development plan of the institution and to supervise its implementation;</p> <p>2.2. To approve the financial plan, budget and annual audited accounts of the institution;</p> <p>2.3. To approve and monitor the financial sustainability of the higher education institution and the fulfillment of its mission</p> <p>2.4. The report the Ministry on the implementation of the strategic plan at latest by March 31 of the following year;</p> <p>2.5. To announce the competition and elect the rector, according to the procedures defined by this law and the statute of the institution;</p>	<p>1. Upravni odbor je nadzorni i organ i odgovoran za strateška i budžetska pitanja javne institucije visokog obrazovanja.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Upravnog odbora su:</p> <p>2.1. Da usvoji strateški plan razvoja institucije i da nadgleda njegovo sprovođenje;</p> <p>2.2. Da odobri finansijski plan, budžet i godišnje revidirane račune institucije;</p> <p>2.3. Da odobri i nadzire finansijsku održivost institucije visokog obrazovanja i ispunjavanje njegove misije;</p> <p>2.4. Da izveštava Ministarstvo o sprovođenju godišnjeg strateškog plana najdalje do 31. marta sledeće godine.</p> <p>2.5. Da raspiše konkurs i izabere rektora, u skladu sa procedurama definisanim ovim zakonom i statutom institucije;</p>

<p>2.6. Të nxjerrë rregullore brenda fushëveprimit dhe detyrave të përcaktuara me këtë ligj dhe statut;</p> <p>2.7. Të ushtrojë detyra dhe përgjegjësi tjera, të përcaktuara me statutin e institucionit.</p> <p>3. Këshilli drejtues do të ketë numër tek të anëtarëve, jo më shumë se nëntë (9) dhe jo më pak se pesë (5) anëtarë. Numri i anëtarëve, varësisht nga specifikat përcaktohet në statutet e institucioneve.</p> <p>4. Anëtarët e Këshillit drejtues zgjidhen për një mandat (3) trevjeçar, pas një procesi të hapur kandidimi dhe kanë të drejtë të rizgjidhen edhe për një mandat. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues nuk mund të fillojë në vitin e njëjtë akademik kur fillon mandati i anëtarëve të Senatit dhe Rektorit.</p> <p>5. Shumica absolute e anëtarëve të Këshillit drejtues zgjidhen nga vet institucioni nga radhët e profesorëve të rregullt ose profesorëve të asocuar. Një anëtar i Këshillit nga radhët e institucionit mund të jetë nga komuniteti akademik ndërkombëtar. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit drejtues si dhe numri i anëtarëve</p>	<p>2.6. To issue regulations within the scope and tasks defined by this law and statute.</p> <p>2.7. To exercise other duties and responsibilities defined by the statute of the institution.</p> <p>3. The Steering Council will have a number of members, not more than nine (9) and not less than five (5) members. The number of members, depending on the specifics is determined in the statutes of the institutions.</p> <p>4. The members of the Steering Council are elected for a (3) three-year term, after an open candidacy process and have the right to be re-elected for another term. The term of the Steering Council members may not begin in the same academic year as the term of the Senate members and the Rector.</p> <p>5. The absolute majority of the Steering Council members are elected by the institution itself from the ranks of full professors or associate professors A member of the Council from among the institution may be from the international academic community. The procedure for electing the members of the Steering Council, as well as</p>	<p>2.6. Da donosi pravilnike u okviru oblast delovanja i zadataka definisanim ovim zakonom i statutom.</p> <p>2.7. Da primenjuje i druge dužnosti i odgovornosti definisane statutom institucije.</p> <p>3. Upravni odbor će imati neparni broj članova, ne više od devet (9) i ne manje od pet (5) članova. Broj članova, u zavisnosti od specifičnosti određuje u statutima institucija.</p> <p>4. Članovi Upravnog odbora biraju se na period od (3) tri godine, nakon otvorenog procesa kandidature i imaju pravo da budu ponovo izabrani još izabrani za drugi mandat. Mandat članova Upravnog odbora ne može započeti iste akademske godine kada započinje i mandat članova Senata i rektora.</p> <p>5. Apsolutnu većinu članova Upravnog odbora bira sama institucija iz redova redovnih profesora ili vanrednih profesora Jedna član Saveta iz redova institucije može biti iz međunarodne akademske zajednice. Procedura izbora članova Upravnog odbora, kao i broj međunarodnih članova, utvrđuje se statutom institucije.</p>
--	---	--

<p>ndërkombëtarë, përcaktohen me statutin e institucionit.</p> <p>6. Nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit drejtues zyrtarët të cilët janë të emëruar në pozita drejtuese në institucionin publik të arsimit të lartë.</p> <p>7. Ministri emëron anëtarët e jashtëm të Këshillit drejtues, numri i të cilëve duhet të jetë më i vogël sesa numri i anëtarëve të zgjedhur nga institucioni, për një anëtar/e. Anëtarët e Këshillit drejtues që emërohen nga ministri, duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik dhe të arritura të veçanta në shkencë, aktivizim shoqëror ose afarizëm.</p> <p>8. Anëtar i Këshillit drejtues nuk mund të jetë: personi që ka ndonjë pozitë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe/ose ka statusin e zyrtarit të lartë publik në kuptim të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit mbi çfarëdo baze tjetër, përveç si anëtar i Këshillit drejtues të institucionit, personi aksionar, bashkëpronar ose i punësuar në institucione private të licencuara të arsimit të lartë në Kosovë, si dhe anëtarët e organeve drejtuese të institucioneve tjera të arsimit të lartë, të partive politike dhe të organizatave sindikale.</p>	<p>the number of international members, are determined by the statute of the institution.</p> <p>6. Officials who are appointed to leading positions in the public institution of higher education may not be members of the Steering Council.</p> <p>7. The Minister appoints the external members of the Steering Council, the number of which must be less than the number of members elected by the institution, per member. The members of the Steering Council appointed by the Minister must be persons with a high public reputation and special achievements in science, social activism or business.</p> <p>8. The member of the Steering Council may not be: a person who holds a position in the Government of the Republic of Kosova, and / or has the status of senior public official within the meaning of the Law on Prevention of Conflict of Interest on any grounds other than as a member of the Steering Council of the institution, shareholder person, co-owner or employed in licensed private institutions of higher education in Kosova, as well as members of the governing bodies of other institutions of higher education, political parties and trade union organizations.</p>	<p>6. Zvaničnici koji su imenovani na rukovodeća mesta u javnoj instituciji visokog obrazovanja ne mogu biti članovi Upravnog odbora.</p> <p>7. Ministar imenuje spoljne članove Upravnog odbora, čiji broj mora biti manji od broja članova koje je izabrala institucija, za jednog člana. Članovi Upravnog odbora koje imenuje ministar moraju biti osobe sa visokom javnom reputacijom i posebnim dostignućima u nauci, društvenom aktivizmu ili poslovanju.</p> <p>8. Član Upravnog odbora ne može biti: lice koje ima položaj u Vladi Republike Kosovo i / ili ima status višeg javnog zvaničnika u smislu Zakona o sprečavanju sukoba interesa po bilo kom osnovu, osim kao članovi Upravnog odbora institucije, akcionari, suvlasnici ili zaposleni u licenciranim privatnim institucijama visokog obrazovanja na Kosovu, kao i članovi upravnih tela drugih institucija visokog obrazovanja, političkih partija i sindikatskih organizacija.</p>
--	--	--



<p>9. Procedura e emërimit të anëtarëve të Këshillit drejtues duhet të përfundojë të paktën tre (3) muaj para skadimit të mandatit të përbërjes aktuale të Këshillit drejtues.</p> <p>10. Të gjithë anëtarët e Këshillit drejtues shërbejnë në cilësi individuale dhe përfaqësojnë vetëm interesin e institucionit.</p> <p>11. Këshilli drejtues zgjedh kryesuesin nga radhët e anëtarëve të emëruar nga ministri dhe zëvendëskryesuesi prej anëtarëve të zgjedhur nga institucioni. Në rast të mungesës së kryesuesit për çfarëdo arsye, zëvendëskryesuesi e ushtron detyrën e kryesuesit. Në rast se të dy mungojnë, atëherë, këshilli drejtues e cakton një ushtrues detyre të kryesuesit nga anëtarët e mbetur të Këshillit drejtues, për një periudhë jo më shumë se gjashtë (6) muaj.</p> <p>12. Të gjithë anëtarët e Këshillit drejtues shërbejnë me kohë të pjesshme, sipas mandatit dhe takohen sipas nevojës.</p> <p>13. Mandati i anëtarit të Këshillit drejtues përfundon para kohe me rastin e vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.</p>	<p>9. The procedure for appointing the members of the must be completed at least three (3) months before the expiration of the current composition term of the Steering Council.</p> <p>10. All members of the Steering Council serve in individual capacity and represent only the interest of the institution.</p> <p>11. The Steering Council elects the chairperson from among the members appointed by the minister and the deputy chairperson from among the members elected by the Institution. In case of chairperson's absence for any reason, the deputy chairperson exercises the duty of chairperson. If both are missing then, the Steering Council shall appoint an Acting Chairperson from among the remaining members of the Steering Council for a term not exceeding six (6) months.</p> <p>12. All members of the Steering Council serve part-time, according to the mandate and meet as needed.</p> <p>13. The term of a member of the Steering Council ends prematurely in case of death, resignation or dismissal, according to the conditions set out in this law.</p>	<p>9. Procedure imenovanje članova Upravnog odbora mora da se završi najmanje tri (3) meseca pre isteka mandata trenutnog sastava Upravnog odbora.</p> <p>10. Svi članovi Upravnog odbora rade u individualnom svojstvu i predstavljaju samo interese institucije.</p> <p>11. Upravni odbor bira predsedavajućeg između članova koje imenuje ministar i zamenika predsedavajućeg, među članove koje je izabrala Institucija. U slučaju odsustva predsedavajućeg iz bilo kog razloga, dužnost predsedavajućeg vrši zamenik predsednika. U slučaju da su obojica odsutni, Upravni odbor imenuje vršioca dužnosti predsedavajućeg iz reda preostalih članova Odbora direktora, na period ne duži od šest (6) meseci.</p> <p>12. Svi članovi Upravnog odbora rade skraćenim radnim vremenom, u skladu sa mandatom i sastaju se po potrebi.</p> <p>13. Mandat člana Upravnog odbora prevremeno prestaje u slučaju smrti, ostavke ili otkaza, prema uslovima utvrđenim ovim zakonom.</p>
---	---	--

<p>14. Anëtari i Këshillit drejtues mund të shkarkohet nga organi që e ka emëruar apo zgjedhur vetëm për këto arsye bindëse si:</p> <p>14.1. Dënim për një vepër penale me vendim të formës së prerë;</p> <p>14.2. Paaftësi në kryerjen e funksioneve të postit për shkak të paaftësisë fizike apo mendore në kohëzgjatje prej 6 muaj, të dokumentuar me një raport nga komisioni mjekësor, të caktuar sipas legjislacionit në fuqi, e që vlerësohet nga autoriteti që ka bërë emërimin;</p> <p>14.3. Dështim, refuzim, shpërfillje, paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara në statutin e institucionit apo në këtë ligj;</p> <p>14.4. Nëse dështon të marrë pjesë në tri takime të njëpasnjëshme pa arsye.</p> <p>15. Nismën për shkarkimin e anëtarit të Këshillit drejtues mund ta jep vet Këshilli drejtues me 2/3 e numrit të përgjithshëm të votave apo 1/3 e anëtarëve të Senatit të institucionit.</p>	<p>14. The member of the Steering Council may be dismissed by the body that has appointed or elected him/her only for these compelling reasons as:</p> <p>14.1. Punishment for a criminal offense by a final decision;</p> <p>14.2. Inability to perform the functions of the position due to physical or mental incapacity for a period of 6 months, documented with a report by the medical commission, appointed according to the legislation in force, and which is assessed by the authority that made the appointment;</p> <p>14.3. Failure, refusal, neglect, persistent inability to fulfill the duties of the post, or to act in accordance with the principles set out in the statute of the institution or in this law;</p> <p>14.4. If you fail to attend three consecutive meetings for no reason.</p> <p>15. The initiative for the dismissal of the member of the Steering Council can be given by the Steering Council itself with 2/3 of the total number of votes or 1/3 of the members of the Senate of the institution.</p>	<p>14. Član Upravnog odbora može biti razrešen od strane organa koji ga je imenovao samo iz sledećih uverljivih razloga:</p> <p>14.1. Osuđivan za krivično delo pravosnažnom odlukom;</p> <p>14.2. Nemogućnost obavljanja funkcija radnog mesta zbog fizičke ili mentalne nesposobnosti u periodu od 6 meseci, dokumentovano izveštajem medicinske komisije, određena u skladu sa važećim zakonodavstvom a koja se procenjuje od strane autoriteta koji je izvršio imenovanje;</p> <p>14.3. Neuspeh, odbijanje, zanemarivanje, kontinuirane nesposobnost da obavlja službenu dužnost ili da postupa u skladu sa principima utvrđenim statutom institucije ili ovim zakonom;</p> <p>14.4. Ako bez razloga ne prisustvujete tri uzastopna sastanka.</p> <p>15. Inicijativu za razrešenje člana Upravnog odbora može dati samo Upravni odbor sa 2/3 ukupnog broja glasova ili 1/3 članova Senata institucije.</p>
--	---	--

<p>16. Në rast të nismës për shkarkim, organi që e ka zgjedhur ose emëruar anëtarin për të cilin propozohet shkarkimi, është i detyruar ta shqyrtojë propozimin në afat prej 30 ditësh.</p> <p>17. Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit drejtues që vijnë nga senati, mund të bëhet me 2/3 të votave të të gjithë anëtarëve të senatit, ndërsa shkarkimin e anëtarëve që vijnë nga Ministria e bën ministri.</p> <p>18. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit drejtues, anëtari i ri zgjidhet apo emërohet për të zëvendësuar anëtarin që largohet, në përputhje me procedurën e përkohshme në këtë nen, për periudhën e mbetur kohore të mandatit të anëtarit që e ka përfunduar mandatin para kohe.</p> <p>19. Organizimi, funksionimi, përbërja, detyrat dhe përgjegjësisë dhe aspektet e tjera të nevojshme për Këshillin drejtues rregullohen me Statutin e IAL.</p>	<p>16. In case of the initiative for dismissal, the body that has elected or appointed the member for whom the dismissal is proposed, is obliged to review the proposal within 30 days.</p> <p>17. The dismissal of the members of the Steering Council coming from the senate can be done with 2/3 of the votes the of the all senate members, while the dismissal of the members coming from the Ministry is done by the minister.</p> <p>18. In case of early termination of the term of the member of the Steering Council, the new member is elected or appointed to replace the outgoing member, in accordance with the procedure described in this article, for the remaining period of the term of the member who has completed it. mandate ahead of time.</p> <p>19. The organization, functioning, composition, duties and responsibilities and other necessary aspects for the Steering Council are regulated by the Statute of the HEI.</p>	<p>16. U slučaju inicijative za razrešenje, organ koji je izabrao ili imenovao člana za koga se predlaže razrešenje, dužan je da razmotri predlog u roku od 30 dana.</p> <p>17. Razrešenje članova Upravnog odbora koji dolaze iz senata, može se izvršiti sa 2/3 glasova članova senata, dok razrešenje članova koji dolaze iz Ministarstva vrši ministar.</p> <p>18. U slučaju prevremenog prestanka mandata člana Upravnog odbora, novi član se bira ili imenuje da zameni člana koji napušta, u skladu sa procedurom opisanim u ovom članu, za preostali vremenski period mandata člana koji je završio mandat pre vremena</p> <p>19. Organizovanje, funkcionisanje, sastav, dužnosti i odgovornosti i drugi neophodni aspekti za Upravni odbor regulišu se Statutom IVO-a.</p>
<p><b>Neni 25</b> <b>Rektori</b></p>	<p><b>Article 25</b> <b>Rector</b></p>	<p><b>Član 25</b> <b>Rektor</b></p>
<p>1. Autoriteti më i lartë menaxherial dhe udhëheqës i një institucioni publik të arsimit</p>	<p>1. The highest managerial authority and leader of a public institution of higher</p>	<p>1. Najviši upravljajući autoritet i rukovodilac javne institucije visokog obrazovanja je</p>

<p>të lartë është Rektori, i cili është përfaqësuesi ligjor sipas përcaktimeve të këtij Ligji.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të rektorit janë:</p> <p>2.1. Të veprojë në emër të institucionit dhe ta përfaqësojë atë para publikut, brenda dhe jashtë vendit;</p> <p>2.2. Në bashkëpunim me Këshillin drejtues dhe senatin të hartoj planin strategjik të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë;</p> <p>2.3. Të jep propozime në Senat për ndryshimin e statutit;</p> <p>2.4. Të punësojë, delegojë, nivelizojë, promovojë, suspendojë dhe përcaktojë kushtet e punës për personel, në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet e brendshme në fuqi;</p> <p>2.5. Të vendosë një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë dhe procedurat e llogaridhënies dhe raportimit në përputhje me ligjet në fuqi si dhe politikat që i cakton senati;</p>	<p>education is the Rector, who is the legal representative as defined by this Law.</p> <p>2. The main duties and responsibilities of the Rector are:</p> <p>2.1. To act on behalf of the institution and represent it to the public, inside and outside the country;</p> <p>2.2. In cooperation with the Steering Council and Senate drafts a strategic plan for the development of the higher education institution;</p> <p>2.3. To give proposals at the Senate for the statute amendment;</p> <p>2.4. To hire, delegate, level, promote, suspend and determine the working conditions for personnel in accordance with the legal provisions and internal acts in force;</p> <p>2.5. To establish an internal quality assurance system and accountability and reporting procedures in accordance with applicable laws and policies set by the senate;</p>	<p>rektor, koji je zakonski zastupnik u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p>2. Glavne dužnosti i odgovornosti rektora su:</p> <p>2.1. Da deluje u ime institucije i predstavlja instituciju u javnost, unutra i inostranstvu;</p> <p>2.2. U saradnji sa Upravnim odborom i senatom da sastave strateški plan za razvoj institucije visokog obrazovanja;</p> <p>2.3. Da iznese predloge Senatu za promenu statuta;</p> <p>2.4. Da zaposli, delegira, izjednači, unapredi, suspendovati i utvrditi uslove rada osoblja u skladu sa važećim zakonskim odredbama;</p> <p>2.5. Da uspostaviti unutrašnji sistem obezbeđivanje kvaliteta i procedure odgovornosti i izveštavanja u skladu sa važećim zakonima kao i politikama koje je odrešuje Senat;</p>
---	--	--

<p>1. Studentët që janë pranuar dhe regjistruar në institucionin e arsimit të lartë kanë të drejtat e mëposhtme, që mund të specifikohen më tej në statutin e institucionit:</p> <p>1.1. Të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadër të programit të studimit ku ata janë regjistruar;</p> <p>1.2. Të përdorin infrastrukturën që institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të procesit mësimor si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga ai institucion;</p> <p>1.3. Të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji dhe statutin e institucionit;</p> <p>1.4. Të marrin pjesë në zgjedhjet për pozitat e studentëve në organizmat e ngritur mbi bazën e statutit të institucionit;</p>	<p>1. Students who have been admitted and enrolled in the institution of higher education have the following rights, which may be further specified in the statute of the institution:</p> <p>1.1. To attend all learning activities that take place within the study program where they are enrolled.</p> <p>1.2. To use the infrastructure that the institution of higher education makes available to the learning process and to benefit from the support services that are provided by that institution.</p> <p>1.3. To participate in the decision-making processes of the higher education institution in accordance with the provisions of this Law and the statute of the institution;</p> <p>1.4. To participate in elections for student positions in bodies set up on the basis of the statute of the institution;</p>	<p>1. Studenti koji su primljeni i upisani u institucijama visokog obrazovanja imaju sledeća prava, koja se mogu dalje specifikovati u statutu te institucije.</p> <p>1.1. Da pohađa sve nastavne aktivnosti koje se odvijaju u okviru studijskog programa gde su oni upisali.</p> <p>1.2. Da koristite infrastrukturu koju institucija visokog obrazovanja stavlja na raspolaganje za nastavni proces i iskoristite i da iskoriste usluge podrške koje pruža ta institucija</p> <p>1.3. Da učestvuje u procesima odlučivanja institucije visokog obrazovanja u skladu sa odredbama ovog zakona i statutom institucije.</p> <p>1.4. Da učestvuju na izborima za studentska mesta u organima osnovanim na osnovu statuta institucije;</p>

<p>1.5. Të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionin e arsimit të lartë.</p> <p>2. Studentët kanë detyrimet si në vijim:</p> <p>2.1. Të respektojnë Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë;</p> <p>2.2. Të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë;</p> <p>2.3. Të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;</p> <p>2.4. T'i kushtojnë vëmendjen e duhur e të plotë studimeve dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;</p> <p>2.5. Të paguajnë tarifat e përcaktuara nga Ministria dhe nga institucionet e arsimit të lartë si dhe tarifat e shërbimeve që u ofrojnë institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>3. Në statutin e institucionit mund të përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera të studentëve.</p> <p>4. Statuti i çdo institucioni të arsimit të lartë përmban dispozita, të cilat:</p>	<p>1.5. To express their appreciation for the quality of teaching and the work of the staff in the higher education institution.</p> <p>2. Students have the following obligations:</p> <p>2.1. To respect the Code of Ethics of the higher education institution;</p> <p>2.2. To implement the rules set by the higher education institution;</p> <p>2.3. To respect the rights of staff and other students;</p> <p>2.4. To pay proper and full attention to studies and participate in academic activities;</p> <p>2.5. To pay the fees set by the Ministry and the institutions of higher education as well as the fees of the services provided by the institutions of higher education;</p> <p>3. Other rights and duties of students can be defined in the statute of the institution.</p> <p>4. The statute of each higher education institution contains provisions, which:</p>	<p>1.5. Da izraze svoju procenu za kvalitet nastave i rad osoblja u instituciji visokog obrazovanja.</p> <p>2. Studenti imaju sledeće obaveze:</p> <p>2.1. Da poštuju etički kodeks institucije visokog obrazovanja;</p> <p>2.2. Da primenjuju pravila koja je postavila institucija visokog obrazovanja;</p> <p>2.3. Da poštuju prava osoblja i drugih studenata;</p> <p>2.4. Da posvete odgovarajuću i punu pažnju studijama i da učestvuju u akademskim aktivnostima;</p> <p>2.5. Da plaćaju tarife koje određuje Ministarstvo i institucije visokog obrazovanja, kao i tarife za usluge koje pružaju institucije visokog obrazovanja;</p> <p>3. U statutu institucije mogu biti utvrđena kao i prava i dužnosti ostalih studenata.</p> <p>4. Statut svake institucije visokog obrazovanja sadrži odredbe koje:</p>
---	---	--

<p>4.1. Garantojnë lirinë e studentëve brenda ligjit për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga institucioni;</p> <p>4.2. Garantojnë lirinë e fjalës, të organizimit e të tubimit sipas dispozitave ligjore;</p> <p>4.3. Mbrojnë studentët nga çdo lloj diskriminimi;</p> <p>4.4. Sigurojnë mekanizma të paanshëm dhe objektivë për trajtimin e çështjeve disiplinore që kanë të bëjnë me studentët.</p> <p>5. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies. Statuti përmban dispozita mbi trajtimin e drejtë të ankesave të tilla.</p> <p>6. Rrethanat në bazë të të cilave studentët mund të çregjistrohen për arsye akademike apo disiplinore si dhe procedurat për ankesë përcaktohen më hollësisht në statutin e institucionit.</p> <p>7. Studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim, ose</p>	<p>4.1. Guarantee the freedom of students within the law to present new ideas and controversial opinions without risking losing the student seat or privileges they may enjoy from the institution;</p> <p>4.2. Guarantee freedom of speech, organization and of gathering according to legal provisions;</p> <p>4.3. Protect students from all forms of discrimination;</p> <p>4.4. Provide impartial and objective mechanisms for dealing with disciplinary matters relating to students.</p> <p>5. Students have the right to complain about the quality of the teaching process. The statute contains provisions on the fair treatment of such complaints.</p> <p>6. The circumstances on the basis of which students may be deregistered for academic or disciplinary reasons as well as the complaint procedures are defined in more detail in the statute of the institution.</p> <p>7. Students enjoy the right to challenge a decision or action, or inaction of the higher</p>	<p>4.1. Garantuju slobodu studentima u okviru zakona da iznose nove ideje i kontroverzna mišljenja bez da rizikuju da izgube studentsko mesto ili privilegije koje mogu uživati u instituciji;</p> <p>4.2. Garantuje slobodu govora, organizacije i okupljanja u skladu sa zakonskim odredbama;</p> <p>4.3. Zaštiti studenata od svake vrste diskriminacije;</p> <p>4.4. Obezbeđuje nepristrasne i objektivne mehanizme za bavljenje disciplinskim pitanjima koja se odnose na studente.</p> <p>5. Studenti imaju pravo da se žale na kvalitet nastavnog procesa. Statut sadrži odredbe o pravilnom postupanju sa takvim žalbama.</p> <p>6. Okolnosti na osnovu kojih se studenti mogu odjaviti iz akademskih ili disciplinskih razloga, kao i žalbene procedure detaljnije su definisani statutom institucije.</p> <p>7. Studenti uživaju pravo da ospore odluku, radnju ili nečinjenje institucije visokog</p>
---	--	--

<p>mosveprim të institucionit të arsimit të lartë, duke i parashtruar një ankesë fillimisht Ministrisë dhe më pas në gjykatën kompetente.</p>	<p>education institution, by filing an appeal first with the Ministry and then with the competent court.</p>	<p>obrazovanja, podnošenjem žalbe prvo Ministarstvu, a zatim nadležnom sudu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Njohja e diplomave të huaja</b></p> <p>1. Njohja e diplomave të huaja të arsimit të lartë bëhet nga ENIC/NARIC Kosova, konform praktikave më të mira ndërkombëtare.</p> <p>2. Procedura për njohjen e diplomave të huaja rregullohet me akt nënligjor.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Recognition of foreign diplomas</b></p> <p>1. Recognition of foreign diplomas of higher education is done by ENIC / NARIC Kosova in accordance to the international best practices;</p> <p>2. The procedure for recognition of foreign diplomas is regulated by a sub-legal act.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Priznavanje stranih diploma</b></p> <p>1. Priznavanje stranih diploma visokog obrazovanja vrši ENIC/NARIC Kosovo u skladu sa najboljom međunarodnom praksom;</p> <p>2. Postupak priznavanja stranih diploma uređuje se podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Transferimi i ECTS kredive</b></p> <p>1. Kreditë ECTS mund të transferohen ndërmjet programeve të ndryshme.</p> <p>2. Kriteret dhe kushtet për transferim të ECTS kredive sipas këtij neni, duhet të përshkruhen me rregullore të IAL-ve ose përmes kontratave ndërmjet këtyre institucioneve.</p> <p>3. Gjatë hartimit të rregulloreve përkatëse ose të nënshkrimit të kontratave, IAL-të duhet të zbatojnë standarde të modeleve të ndryshme evropiane për transferim të kredive.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Transfer of ECTS credits</b></p> <p>1. ECTS credits can be transferred through different programs.</p> <p>2. Criteria and conditions for transfer of ECTS credits according to this Article, should be described with HEIs regulation or through contracts between these institutions.</p> <p>3. During drafting the relevant regulations or signing contracts, HEIs must apply standards of various European models for the credit transfer.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Prenos ECTS kredita</b></p> <p>1. ECTS krediti se mogu prenositi između različitih programa.</p> <p>2. Kriterijumi i uslovi za prenos ECTS kredita prema ovom članu, moraju biti opisani uredbom IVO-a ili ugovorima između ovih institucija.</p> <p>3. Prilikom izrade relevantnih propisa ili potpisivanja ugovora, IVO moraju da primenjuju standarde različitih evropskih modela za prenos kredita..</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 36</b> <b>Revokimi i titullit akademik ose gradës shkencore/artistike “doktor i shkencave/arteve”</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 36</b> <b>Revocation of the academic title or scientific / artistic degree "Doctor of Science / Arts"</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 36</b> <b>Oduzimanje akademske titule ili naučnog/umetničkog stepena „doktor nauka/umetnosti“</b></p>
<p>1. Titulli akademik i fituar në një institucion të arsimit të lartë në Kosovë, mund të revokohet:</p> <p>1.1. Nëse konstatohet se punimet shkencore/artistike mbi bazën e të cilave personi është emëruar në titullin akademik përkatës paraqesin plagjiat ose bazohen në hulumtime të falsifikuara;</p> <p>1.2. Në rastet e shkeljeve të rënda të kodit etik.</p> <p>2. Grada shkencore/artistike “doktor i shkencave/arteve”, e fituar në një institucion të arsimit të lartë në Kosovë mund të revokohet nëse konstatohet se disertacioni i doktoratës nuk ka qenë punim i vetë kandidatit, është plagjiat apo formë tjetër e rëndë e praktikës joetike.</p> <p>3. Procedurën për revokimin e titullit akademik ose gradës shkencore/artistike “doktor i shkencave/arteve”, mund ta iniciojë institucioni i arsimit të lartë që e ka</p>	<p>1. The academic title obtained in a higher education institution in Kosova can be revoked:</p> <p>1.1. If it is found that the scientific / artistic works on the basis of which the person has been appointed to the respective academic title presents plagiarism or are based on falsified research;</p> <p>1.2. In cases of serious violations of the code of ethics.</p> <p>2. The scientific / artistic degree "Doctor of Science / Arts" obtained in a higher education institution in Kosova can be revoked if it is found that the doctoral dissertation was not the work of the candidate, is plagiarism or another serious form of unethical practice.</p> <p>3. The procedure for revoking the academic title or scientific / artistic degree "Doctor of Science / Arts" can be initiated by the higher education institution that has awarded the</p>	<p>1. Akademska titula stečena u instituciji visokog obrazovanja na Kosovu može se oduzeti:</p> <p>1.1. ako se utvrdi da su naučni/umetnički radovi na osnovu kojih je lice dobilo odgovarajuće akademsko zvanje predstavlja plagijiat ili zasnovani na falsifikovanom istraživanju;</p> <p>1.2. u slučajevima težeg kršenja etičkog kodeksa.</p> <p>2. Naučni/umetnički stepen „Doktor nauka/umetnosti“ stečena u instituciji visokog obrazovanja na Kosovu može se oduzeti ako se utvrdi da doktorska disertacija nije delo samog kandidata, da je plagijiat ili drugi ozbiljan neetičke prakse.</p> <p>3. Postupak za oduzimanje akademskog zvanja ili naučnog/umetničkog stepena „doktor nauka/umetnosti“ može pokrenuti institucija visokgo obrazovanja koja je stekla</p>

<p>dhënë titullin, respektivisht gradën shkencore/artistike ose Komiteti Etik.</p> <p>4. Në rast të inicimit të procedurës, e njëjta duhet të përfundojë në afat prej 6 muajsh.</p>	<p>title, respectively the scientific / artistic degree or the Ethics Committee.</p> <p>4. In case of initiating the procedure, it must be completed within 6 months.</p>	<p>zvanje, odnosno naučnu/umetničku diplomu ili Komitet za etiku.</p> <p>4. U slučaju iniciranje postupka, on mora biti okončan u roku od 6 meseci.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Organizimi i studentëve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Students organization</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Organizovanje studenata</b></p>
<p>1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore si dhe në forma të tjera brenda njërive akademike, të institucionit të arsimit të lartë si dhe në nivel kombëtar.</p> <p>2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve nëpër institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në veprimtaritë mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.</p> <p>3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy (2) vjet me votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati</p>	<p>1. Students have the right to be organized into student councils, and in other forms of the academic unit of the higher education institution as well at the national level.</p> <p>2. Student councils are independent student organizations in higher education institutions that do not develop political or economic activities. These councils promote student participation and coordinate their representation in the governing bodies of higher education institutions, in teaching-research activities and services.</p> <p>3. Student councils are elected every two (2) years with student votes and are based on the legislation in force. In cases where an individual elected to the student council completes his / her university studies, he / she is replaced by the next candidate in the</p>	<p>1. Studenti imaju pravo da budu organizovani u savete studenata kao i druge oblike unutar akademskih jedinica, institucija visokog obrazovanja kao i na nacionalnom nivou.</p> <p>2. Saveti studenata su nezavisne studentske organizacije u institucijama visokog obrazovanja, koje ne obavljaju političke i ekonomske delatnosti. Ova veća promovišu učešće studenata i koordiniraju njihovo predstavljanje u upravnim telima institucijama visokog obrazovanja, u nastavno-istraživačkim delatnostima i uslugama.</p> <p>3. Saveti studenata biraju se svake dve (2) godine glasanjem studenata i zasnivaju se na važećem zakonodavstvu. U slučajevima kada određeni pojedinac u savet studenata završi univerzitetske studije, on se zamenjuje sa sledećim kandidatom u rang</p>

<p>pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit.</p> <p>4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre, përcaktohen në statutet dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj.</p> <p>5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planifikimin strategjik, planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive.</p> <p>6. Institucionet e arsimit të lartë mbështesin këshillat e studentëve dhe mund të kontribuojnë në financimin e aktiviteteve të tyre.</p>	<p>ranking according to the number of votes gathered in the last elections.</p> <p>4. Student councils cannot be organized with other political and non-political structures, outside the relevant institutions of higher education. Modalities and procedures for their establishment, organization and functioning are defined in the statutes and regulations of higher education institutions, in accordance with this Law.</p> <p>5. Student councils' express opinions and proposals on all issues of general interest to higher education institutions, such as strategic planning, study plans and programs, regulations for teaching activities, the right to study, the quality of services, the definition of tuition fees and other financial contributions for students, preliminary annual balance sheets of expenditures or allocation of financial resources, development of various cultural, artistic, sports activities</p> <p>6. Higher education institutions support student councils and can contribute to the financing of their activities.</p>	<p>prema broju glasova prikupljenih na poslednjim izborima.</p> <p>4. Saveti studenata ne mogu se organizovati sa drugim političkim i nepolitičkim strukturama, izvan relevantnih institucija visokog obrazovanja. Modaliteti i procedure za njihovo uspostavljanje, organizovanje i funkcionisanje definisani su statutima i propisima institucijama visokog obrazovanja, u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>5. Saveti studenata izražavaju mišljenja i predloge o svim pitanjima od opšteg interesa za institucije visokog obrazovanja, kao za strateško planiranje, planovi i programi studija, propisi o nastavnim delatnostima, pravo na studiranje, kvalitet usluga, definisanje školarine i druge finansijske doprinose za studente, prethodne godišnje bilanse potrošnje ili podeli finansijskih sredstava, razvoj raznih kulturnih, umetničkih, sportskih delatnosti.</p> <p>6. Institucije visokog obrazovanja podržavaju savete studenata i mogu doprineti finansiranju njihovih aktivnosti.</p>
--	--	---

<p>7. Unioni i Studentëve të Republikës së Kosovës (USRK), është organizatë studentore e përfaqësimit të të gjithë studentëve të Kosovës. Struktura, funksionimi dhe format e mbështetjes për USRK, rregullohen me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Mbështetja financiare për studentët</b></p> <p>1. Ministri mund të nxjerrë akt nënligjor për krijimin e skemës apo skemave për mbështetje financiare të studentëve, bazuar në merita ose nevoja ekonomike dhe sociale.</p> <p>2. Skema të tilla të mbështetjes financiare për studentët, mund të përfshijnë dispozita që ndihmojnë studentët në pagesat për shkollim dhe në pagesa të tjera të institucioni publik dhe sipas vlerësimit të Ministrit të institucioni privat i arsimit të lartë.</p> <p>3. Institucionet publike të arsimit të lartë, mund të krijojnë skema për mbështetje financiare për studentët, me fonde që nuk ndahen nga burime publike.</p> <p>4. Ministri ndërmerr veprime që konsideron se janë të dobishme dhe të nevojshme për të garantuar që studentët e regjistruar në cilindo institucion të kenë mundësi dhe qasje të barabartë për të aplikuar në skemën apo skemat ekzistuese të</p>	<p>7. Student Union of the Republic of Kosova (SURK) is a student organization representing all students of Kosova. The structure, functioning and forms of support for SURK are regulated by a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Students financial support</b></p> <p>1. The Minister may issue a sub-legal act for the establishment of the scheme or schemes for financial support of students, based on merit or economic and social needs.</p> <p>2. Such financial support schemes for students, may include provisions that assist students in tuition and other payments to the public institution and at the discretion of the Minister to the private institution of higher education.</p> <p>3. Public institutions of higher education, can create schemes for financial support for students, with funds not allocated from public sources</p> <p>4. The Minister undertakes actions that considers to be useful and necessary to ensure that students enrolled in any institution have equal opportunities and access to apply to the existing financial support scheme or schemes</p>	<p>7. Unija Studenata Republike Kosova (USRK) je studentska organizacija koja predstavlja sve studente na Kosovu. Struktura, funkcionisanje i oblik podrške USRK, uređuje se podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Finansijska podrška studentima</b></p> <p>1. Ministar može doneti podzakonski akt za stvaranje šeme ili šema za finansijsku podršku studentima, na osnovu zasluga ili ekonomskih i socijalnih potreba.</p> <p>2. Takve šeme za finansijsku podršku studentima, mogu uključivati odredbe koje pomažu studentima u školarinama i drugim uplatama javnoj instituciji, i prema proceni ministra privatnoj instituciji visokog obrazovanja.</p> <p>3. Javne institucije visokog obrazovanja, mogu stvoriti šeme za finansijsku podršku studentima, fondovima koji se ne dodeljuju iz javnih izvora.</p> <p>4. Ministar preduzima radnje koje smatra da su korisne i neophodne kako bi se osiguralo da studenti upisani u bilo koju instituciju imaju jednake mogućnosti i pristup da se prijave za postojeću šemu finansijske</p>
--	--	--

<p>mbështetjes financiare për studentët, që janë në përputhje me këtë nen.</p> <p>5. Rregullat e përcaktuara nga një institucion publik i arsimit të lartë mund të përcaktojnë rrethanat, në bazë të të cilave studentëve që paguajnë shkollimin dhe që arrijnë rezultate të shkëlqyeshme në mësim, mund t'u ndahet një vend studimi i financuar me fonde publike në vitin e dytë apo në vitin vijues të studimit.</p> <p>6. Të gjitha organizatat e financuara me fonde publike që u sigurojnë studentëve strehim, ushqim, ndihmë mjekësore dhe sociale, u nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji. Ministri mund t'i udhëzojë këto organizata lidhur me detyrimet, qeverisjen dhe tarifat.</p> <p>7. Ministria mbështetë dhe financo funksionimin e Qendrave të Studentëve të cilat ofrojnë banim, ushqim dhe shërbime tjera për studentët. Funksionimi dhe forma e administrimit të Qendrave të Studentëve rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri.</p>	<p>for students that are in accordance with this article.</p> <p>5. Rules set by a public institution of higher education may determine the circumstances under which students who pay tuition and achieve excellent academic performance may be allocated a publicly funded study place in the year second or in the following year of study.</p> <p>6. All publicly funded organizations that provide students with accommodation, food, medical and social assistance are subject to the provisions of this Law. The Minister may instruct these organizations regarding obligations, governance and fees.</p> <p>7. The Ministry supports and finances the operation of Student Centers which provide accommodation, food and other services for students. The functioning and form of administration of the Student Centers is regulated by a sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>podrške ili šeme za studente koje su u skladu sa ovim članom.</p> <p>5. Pravila koja je postavila javna institucija visokog obrazovanja mogu odrediti okolnosti na osnovu koje studenti plaćaju školarinu i postizu odlične uspehe u nastavi, može biti dodeljeno finansiranje javnim fondovima na drugoj godini ili narednoj godini studija.</p> <p>6. Sve organizacije koje se javno finansiraju i koje studentima pružaju smeštaj, hranu, medicinsku i socijalnu pomoć podležu odredbama ovog zakona. Ministar može uputiti ove organizacije o obavezama, upravljanju i naknadama.</p> <p>7. Ministarstvo podržava i finansira funkcionisanje Studentskih centara koji studentima omogućavaju smeštaj, hranu i druge usluge. Funkcionisanje i oblik uprave Studentskih centara regulisan je podzakonskim aktom koji donosi ministar.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Karta e studentit</b></p> <p>1. Studentët e institucioneve të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit. Me anë të saj, studentët përfitojnë lehtësira dhe shërbime me çmime të reduktuara në shërbimet publike.</p> <p>2. Ministria me akt nënligjor, përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Student card</b></p> <p>1. Students of higher education institutions are provided with a student card. Through it, students benefit facilities and services at reduced prices in public services.</p> <p>2. The Ministry with a sub-legal act, determines the criteria and procedures for the preparation and issuance of the student card.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Studentska karta</b></p> <p>1. Studenti institucija visokog obrazovanja dobijaju studentsku karta. Njome studenti imaju olakšice i usluge po sniženim cenama u javnim uslugama.</p> <p>2. Ministarstvo podzakonskim aktom , utvrđuje kriterijume i procedure za pripremu i izdavanje studentske karte.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Baza e të dhënave të studentëve</b></p> <p>1. Institucionet e arsimit të lartë ruajnë të dhënat personale të studentëve.</p> <p>2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>3. Ministria mbledh dhe përpunon të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Student database</b></p> <p>1. Higher education institutions, keep students' personal data.</p> <p>2. All storage processes and personal data processing of students by higher education institutions are carried out based on the principle of confidentiality and in accordance with legislation in force on personal data protection.</p> <p>3. The Ministry collects and processes data from higher education institutions, in accordance with applicable legislation on personal data protection.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Baza podataka studenata</b></p> <p>1. Institucije visokog obrazovanja , čuvaju lične podatke studenata.</p> <p>2. Svi procesi čuvanja i obrade ličnih podataka studenata od strane institucije visokog obrazovanja, sprovode se na principu poverljivosti i u skladu sa važećim zakonodavstvom o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>3. Ministarstvo prikuplja i obrađuje podatke institucije visokog obrazovanja, u skladu sa važećim zakonodavstvom o zaštiti ličnih podataka.</p>

<p>4. Ministria do të caktojë treguesit për raportim të të dhënave me akt nënligjor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>5. Institucionet e arsimit të lartë mbledhin, ruajnë dhe gjenerojnë statistika për studentët, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>6. Ministria zhvillon dhe e mirëmban Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL).</p> <p>7. SMIAL ndërlidh informatat statistikore të institucioneve të arsimit të lartë me ministrinë, duke krijuar mundësitë e analizave të treguesve arsimorë dhe të orientimit të politikave zhvillimore në arsimin e lartë.</p> <p>8. Ministria përkatëse e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përcakton treguesit për raportim të të dhënave me akt nënligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi</p>	<p>4. The Ministry will set the indicators for data reporting by sub-legal act and in accordance with the legislation in force for personal data protection.</p> <p>5. Higher education institutions collect, store and generate statistics for students, based on the legislation in force for personal data protection.</p> <p>6. The Ministry develops and maintains the Higher Education Information Management System (HEIMS).</p> <p>7. HEIMS links the statistical information of higher education institutions with the ministry, creating opportunities for analysis of educational indicators and development policy orientation in higher education.</p> <p>8. The relevant Ministry of Education, Science, Technology and Innovation determines the indicators for data reporting with a sub-legal act, in accordance with the legislation in force.</p>	<p>4. Ministarstvo će odrediti pokazatelje za izveštavanje podataka podzakonskim aktom i u skladu sa zakonodavstvom na snazi za zaštitu ličnih podataka.</p> <p>5. Institucije visokog obrazovanja prikupljaju, čuvaju i generišu statistiku za studente, na osnovu važećeg zakonodavstva o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>6. Ministarstvo razvija i održava Sistem menadžiranja informacijama o visokom obrazovanju (SMIVO).</p> <p>7. SMIVO povezuje statističke podatke institucija visokog obrazovanja sa ministarstvom, stvarajući mogućnosti za analizu obrazovnih pokazatelja i orijentaciju razvojnih politika u visokom obrazovanju.</p> <p>8. Relevantno Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije određuje pokazatelje za izveštavanje podataka podzakonskim aktom, u skladu sa važećim zakonodavstvom</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Financial resources of public institutions of higher education</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Izvori finansiranje javnih institucija visokog obrazovanja</b></p>
<p>1. Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:</p>	<p>1. Higher education public institutions are financed by:</p>	<p>1. Javne institucije visokog obrazovanja finansiraju se iz:</p>

<p>1.1. Buxheti i Kosovës;</p> <p>1.2. Pagesat e studentëve për arsimim;</p> <p>1.3. Të ardhurat për shërbimet e kryera;</p> <p>1.4. Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;</p> <p>1.5. Donacione dhe ndihmesa të tjera;</p> <p>1.6. Veprimtari kërkimore-shkencore;</p> <p>1.7. Kontratat me organe të jashtme, ndërkombëtare, publike apo private në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të këshillimit;</p> <p>1.8. Burime të tjera të ligjshme financimi.</p> <p>2. Institucionet publike të arsimit të lartë rregullojnë në aktet e tyre të brendshme, mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga Buxheti i Kosovës.</p>	<p>1.1. Kosovo's Budget;</p> <p>1.2. Student payments for education;</p> <p>1.3. Revenue for performed services;</p> <p>1.4. Revenue created from agreements with third parties</p> <p>1.5. Donation and other aids;</p> <p>1.6. Scientific-research activities;</p> <p>1.7. Contracts with state, international, public or private bodies in the field of teaching, scientific-research or counseling.</p> <p>1.8. Other legal financial resources.</p> <p>2. Public higher education institutions regulate in their internal acts, the manner of using the funds generated from the revenues defined in this article, with the exception of the revenues from the Kosova Budget.</p>	<p>1.1. Kosovski budžet;</p> <p>1.2. Uplata školarine za obrazovanje;</p> <p>1.3. Prihodi od pruženih usluga;</p> <p>1.4. Prihod ostvaren odnosima sa trećim stranama;</p> <p>1.5. Donacije i druga pomoć;</p> <p>1.6. Naučno – istraživačka delatnost;</p> <p>1.7. Ugovori sa spoljnim međunarodnim, javnim ili privatnim organima u oblasti nastave, naučna istraživanja ili savetovanja;</p> <p>1.8. Ostali legitimni izvori finansiranja.</p> <p>2. Javne institucije visokog obrazovanja uređuju svojim internim aktima način korišćenje sredstava generisanih iz prihode definisanim u ovom članu, sa izuzetkom prihoda iz budžeta Kosova.</p>
--	--	--



<p align="center"><b>Neni 42</b> <b>Autonomia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë</b></p>	<p align="center"><b>Article 42</b> <b>Financial autonomy of public higher education institutions</b></p>	<p align="center"><b>Član 42</b> <b>Finansijska autonomija javnih institucija visokog obrazovanja</b></p>
<p>1. Institucionet publike të arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare.</p> <p>2. Institucioni publik i arsimit të lartë harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan plotësohet çdo vit.</p> <p>3. Përdorimi i të ardhurave nga fondet publike për institucionet e arsimit të lartë bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e buxhetit të akorduar dhe në përputhje me planin strategjik të institucionit të rënë dakord nga Ministria.</p> <p>4. Institucionet publike të arsimit të lartë gëzojnë të drejtën të lidhin kontrata për çfarëdo qëllimi që lidhet me arsimin e lartë dhe në rastet kur kjo është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të tyre, edhe në lidhje me kërkimet shkencore. Institucioni mund t'i investojnë fondet, duke përfshirë ato publike, në cilëndo ndërmarrje me qëllime të arsimit apo të kërkimit shkencor me kusht që:</p>	<p>1. Public higher education institutions operate according to the principle of financial autonomy.</p> <p>2. Public higher education institution drafts a medium-term budget plan, which is part of the strategic development plan of the institution. This plan is completed every year.</p> <p>3. The use of revenues from public funds for higher education institutions is done in accordance with the terms and purposes of the allocated budget and in accordance with the strategic plan of the institution agreed by the Ministry.</p> <p>4. Public higher education institutions enjoy the right to enter into contracts for any purpose related to higher education and in cases where this is part of their strategic development plan, also in relation to scientific research. The institution may invest funds, including public funds, in any enterprise for educational or research purposes provided that:</p>	<p>1. Javne institucije visokog obrazovanja posluju po principu finansijske autonomije.</p> <p>2. Javna institucija visokog obrazovanja sastavlja srednjoročni plan budžeta, koji je deo strateškog plana za razvoj institucije. Ovaj plan se popunjava svake godine.</p> <p>3. Korišćenje prihoda iz javnih sredstava za institucije visokog obrazovanja vrši se u skladu sa rokovima i ciljevima usklađenog budžeta i u skladu sa strateškim planom institucije koji je dogovoreno sa Ministarstvom.</p> <p>4. Institucije visokog obrazovanja uživaju pravo da sklapaju ugovore u bilo koju svrhu koja se odnosi na visoko obrazovanje i u slučajevima kada je to deo njihovog strateškog plana, i u vezi njihovih naučnih istraživanja. Institucija može uložiti sredstva, uključujući javne fondove, u bilo koje preduzeće u cilju obrazovanja ili naučna istraživanja pod uslovom da:</p>

<p>4.1. Ato kontrata të ndërlidhen me projekte që përkrahin planin strategjik të zhvillimit të institucionit;</p> <p>4.2. Asnjë kontratë të mos imponojë ndonjë detyrim financiar ndaj pasurisë dhe pronës publike pa aprovimin e organeve kompetente;</p> <p>4.3. Fondet publike të mos përfshihen në rreziqe të mundshme të cilat rregullohen me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Parimet kryesore të financimit të institucioneve të arsimit të lartë</b></p> <p>1. Institucionet publike të akredituara të arsimit të lartë mund të financohen nga burimet e mëposhtme, sipas dispozitave të përcaktuara në statutet dhe planet strategjike të tyre si:</p> <p>1.1. Fonde nga Ministria për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm;</p> <p>1.2. Pagesa për shkollim dhe pagesa tjera që bëjnë studentët;</p> <p>1.3. Pagesa për shërbime komerciale dhe shërbime të tjera;</p>	<p>4.1. Those contracts should be related to projects supporting the strategic development plan of the institution;</p> <p>4.2. No contract should impose any financial obligation on public property without the approval of the competent authorities;</p> <p>4.3. Public funds should not be included in potential risks which are regulated with the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>The main funding principles of higher education institutions</b></p> <p>1. Accredited public institutions of higher education can be funded from the following sources, according to the provisions set out in their statutes and strategic plans such as:</p> <p>1.1. Funds from the Ministry of general interest for teaching and scientific research;</p> <p>1.2. Tuition payment and other payments made by students;</p> <p>1.3. Payment for commercial and other services;</p>	<p>4.1. Se ti ugovori odnose na projekte koji podržavaju strateški plan razvoja institucije;</p> <p>4.2. Nijedan ugovor da ne nameće bilo kakvu finansijsku obavezu na javnu imovinu bez odobrenja nadležnih organa, i</p> <p>4.3. Javni fondovi da budu uključeni u potencijalne rizike koji su regulisani važećim zakonvstvom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Glavni principi finansiranja institucija visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Akreditovane javne institucije visokog obrazovanja mogu se finansirati iz sledećih izvora, u skladu sa odredbama utvrđenim njihovim statutima i strateškim planovima, kao što su:</p> <p>1.1. Sredstva iz Ministarstvo za nastavu i naučna istraživanja od opšteg interesa;</p> <p>1.2. Školarine i druge isplate koje obavljaju studenti</p> <p>1.3. Plaćanje za komercijalnih i druge usluge;</p>
--	---	--

<p>1.4. Donacione, dhurata, ndihmesa tjera, dhe</p> <p>1.5. Kontrata me organizma shtetërorë, ndërkombëtarë, publik ose privat në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të këshillimit.</p> <p>2. Nëse një institucion i arsimit të lartë publik nuk e fiton riakreditimin në përputhje me këtë ligj, atëherë Ministria, me akt nënligjor, mund të marrë masa të përkohshme për financimin e tij dhe marrjen e pagesave të shkollimit dhe të të ardhurave të tjera gjatë periudhës deri në rimarrjen e akreditimit, mbylljen apo shkrirjen, sikurse parashihet me ligj.</p> <p>3. Ministria mund të sigurojë fonde publike për bartësit privat të arsimit të lartë të licencuar dhe të akredituar në mbështetje të objektivave të Ministrisë.</p> <p>4. Çdo institucion privat i arsimit të lartë i cili pranon fondet publike, i nënshtrohet përgjegjësisë dhe kërkesave të auditimit njëjtë si edhe bartësit publik, siç është përcaktuar në këtë ligj.</p>	<p>1.4. Donation, gifts, other aids and</p> <p>1.5. Contracts with state, international, public or private bodies in the field of teaching, scientific research or counseling.</p> <p>2. If a higher education institution does not gain re-accreditation in accordance with this law, then the Ministry, by sub-legal act may take temporary measures to finance it and receive tuition and other income payments during the period up to re-accreditation, closure or merger, as provided by law.</p> <p>3. The Ministry can provide public funding for licensed and accredited private providers of higher education in support of the Ministry objectives.</p> <p>4. Each private institution of higher education which receives public funds is subject to the same responsibilities and audit requirements as public providers, as defined in this law.</p>	<p>1.4. Donacije, pokloni, druga pomoć i</p> <p>1.5. Ugovori sa državnim, međunarodnim, javnim ili privatnim organizmima u oblasti nastave, naučna istraživanja ili savetovanja.</p> <p>2. Ako institucija visokog obrazovanja ne dobije reakreditaciju u skladu sa ovim zakonom, Ministarstvo, podzakonskim aktom može preduzeti privremene mere za njeno finansiranje i preuzimanje školarine i druge prihode tokom perioda do ponovno dobijanje akreditacije, zatvaranje ili spajanje, kako je predviđeno zakonom.</p> <p>3. Ministarstvo može da obezbedi javna sredstva za licencirane i akreditovane privatne nosioce visokog obrazovanja kao podršku ciljevima Ministarstva.</p> <p>4. Svaka privatna institucija visokog obrazovanja koja dobija javna sredstva podleže odgovornostima i zahtevima revizije isto kao i javni nosioci, kako je definisano ovim zakonom.</p>
---	---	--

<p align="center"><b>Neni 44</b> <b>Metodologjia e financimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 44</b> <b>The funding methodology</b></p>	<p align="center"><b>Član 44</b> <b>Metodologjia finansiranja</b></p>
<p>1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe institucionet publike të arsimit të lartë, Ministria me akt nënligjor përcakton metodologjinë që do të përdoret për caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes publik, së bashku me shtesa të tjera ose koncesione, të cilat mund të miratohen nga Qeveria. Fondet mund të caktohen për qëllime të mësimdhënies, të punës kërkimore në lidhje me mësimdhënien, për infrastrukturë ose për qëllime të tjera.</p> <p>2. Caktimi i fondeve për mësimdhënie e specifikon numrin e studentëve që do të arsimohen me shpenzimet publike në disiplina e fusha të caktuara studimi. Ky numër duhet të jetë në përputhje me numrin maksimal të saktësuar në vendimin e akreditimit të institucionit. Përshkrimi i bashkangjitur për secilën disiplinë apo fushë përcaktohet nëpërmjet një akti nënligjor.</p> <p>3. Ministria cakton fondet e institucioneve të arsimit të lartë, duke marrë parasysh objektivat e specifikuar në planin strategjik të bartësit dhe çfarëdo vërejtjesh apo rekomandimesh nga AKA lidhur me cilësinë e mësimdhënies së këtyre institucioneve ose të programeve të veçanta.</p>	<p>1. In cooperation with the Ministry of Finance and public institutions of education the higher, the Ministry by sub-legal act determines the methodology to be used for the allocation of funds for teaching and research of public interest, together with other additions or concessions, which may be approved by Government. Funds may be allocated for teaching purposes, teaching-related research, infrastructure or other purposes.</p> <p>2. The allocation of funds for teaching specifies the number of students who will be educated at public expense in certain disciplines and fields of study. This number must be in accordance with the maximum number specified in the accreditation decision of the institution. The attached description for each discipline or field is defined by a sub-legal act.</p> <p>3. The Ministry sets the funds of higher education institutions taking into account the objectives specified in the strategic plan of the provider and any remarks or recommendations from the KAA regarding the quality of teaching of these institutions or special programs.</p>	<p>1. U saradnji sa Ministarstvom finansija i javnim institucijama obrazovanja, Ministarstvo podzakonskim aktom utvrđuje metodologiju koja će se koristiti za određivanje sredstava za nastavu i naučna istraživanja od javnog interesa, zajedno sa drugim državljanima ili koncesijama, koje odobri Vlada. Sredstva se mogu biti dodeljena za nastavne svrhe, istraživačkom radu u vezi sa nastavom, za infrastrukturu ili druge svrhe.</p> <p>2. Određivanje sredstava za nastavu određuju broj studenata koji će se školovati o javnom trošku u određenim disciplinama i oblastima studija. Ovaj broj mora da bude u skladu sa maksimalnim brojem navedenim u odluci o akreditaciji institucije. Priloženi opis za svaku disciplinu ili oblast definisan je podzakonskim aktom.</p> <p>3. Ministar određuje sredstva institucijama visokog obrazovanja uzimajući u obzir ciljeve navedene u strateškom planu nosioca i sve primedbe ili preporuke KAA u vezi sa kvalitetom nastave ovih institucija ili posebnih programa.</p>

<p>4. Ministria, bazuar në performancën e fundit të institucionit, do të caktojë një vijë buxhetore për një cikël të financimit pesë (5) vjeçar. Caktimi i fondeve për një institucion duhet të marrë formën e marrëveshjes së performancës, që do të zgjasë tri vjet dhe që do të publikohet nga Ministria, pasi të jetë pajtuar me institucionin përkatës.</p>	<p>4. The Ministry, based on the recent performance of the institution, will set a budgetary line for a funding cycle of five (5) years. The allocation of funds for an institution should take the form of a performance agreement, which will last for three years and will be published by the Ministry, after agreeing with the relevant institution.</p>	<p>4. Ministarstvo, na osnovu poslednje performanse institucije, će odrediti budžetsku liniju ciklus finansiranja za pet (5) godina ciklusa finansiranja. Dodeljivanje sredstava za instituciju trebalo bi da ima oblik sporazuma o performansi, koji će trajati tri godine, i Ministarstvo će objaviti nakon dogovora sa relevantnom institucijom.</p>
<p>5. Fondet caktohen çdo vit si një shumë që i jepet institucionit gjatë vitit financiar në intervale kohe të përcaktuara nga Ministria e Financave, brenda planit strategjik.</p>	<p>5. Funds are allocated each year as an amount given to the institution during the financial year at time intervals determined by the Ministry of Finance, within the strategic plan.</p>	<p>5. Sredstva se određuju svake godine kao iznos koji se dodeljuje instituciji tokom finansijske godine u vremenskim intervalima koje odredi Ministarstvo finansija, u okviru strateškog plana.</p>
<p>6. Këshilli drejtues miraton skemën financiare të delegimit dhe llogaridhënies me nën njësitë buxhetore brenda institucionit përmes së cilës pasqyrohet planifikimi strategjik dhe detyrat mbi raportimin e performancës që ajo i detyrohet Ministrisë.</p>	<p>6. The Steering Council approves the financial scheme of delegation and accountability with budgetary sub-units within the institution through which is reflected the strategic planning and tasks on the performance reporting that it owes to the Ministry.</p>	<p>6. Upravni odbor odobrava finansijsku šemu delegiranja i odgovornosti sa budžetskim podjedinicama u okviru institucije kroz koju se odražava strateško planiranje i zadaci o izveštavanju o performansi koje dužuje Ministarstvu.</p>
<p>7. Skema e tillë do të inkurajojë dhe lehtësojë zhvillimin e kapaciteteve, ngritjen e cilësisë dhe arritjen e rezultateve të dakorduara brenda çdo nën njësie buxhetore.</p>	<p>7. Such a scheme will encourage and ease capacity development, quality enhancement and the achievement of agreed outcomes within each budgetary sub-unit.</p>	<p>7. Takva šema će podstaći i olakšati razvoj kapaciteta, unapređenje kvaliteta i postizanje dogovorenih rezultata u okviru svake budžetske jedinice.</p>
<p>8. Këshilli drejtues nxjerr rregullore financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto marrëveshje do të përfshihen në statutin e institucionit.</p>	<p>8. The Steering Council issues financial regulations in accordance with the legislation in force. These agreements will be included in the statute of the institution</p>	<p>8. Upravni odbor donosi finansijske pravilnik u skladu sa važećim zakonodavstvom. Ovi sporazumi će biti uključeni u statut institucije.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Kushtet e financimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>The funding conditions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Uslovi finansiranja</b></p>
